

**PROGRAMI, MATERIALE DHE BURIME
PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE
ME SKENARË TË PËRGATITUR
PËR SEMINARE**

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare dhe të ekspertëve nga projekti i BE-së
“Rritja e cilësisë së edukimit dhe kujdesit parashkollor”
EuropeAid/139823/IH/SER/MK

Titulli:

PROGRAMI, MATERIALE DHE BURIME PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE
ME SKENARË TË PËRGATITUR PËR SEMINARE

Botues:

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

Për botuesin:

Ministri Fatmir Limani

Autorë:

Ivana Mushkinja

Redaktor:

Prof. Dr. Alma Tasevska

Përpunimi kompjuterik:

TEDI TREJD KOM sh.p.k. Shkup

Përkthimi dhe lektura:

KONTINEO sh.p.k. Shkup

Shtypshkrinja:

TEDI TRADE COM sh.p.k. Shkup

Tirazhi:

100 kopje

CIP - Katalogimi në botim Biblioteka Kombëtare dhe Universitare
“Shën Kliment Ohridski”, Shkup

ISBN: 978-608-249-618-4

COBISS.MK-ID 64658949

Viti dhe vendi i botimit: 2024, Shkup

Shënim

Përmbajtja e këtij doracaku është përgjegjësi e vetme e Archidata s.r.l. dhe partnerët e saj në konsorci-
um dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

1. Doracak për profesionistët.....	6
1.1. Si përdoret ky doracak	6
1.2. Çfarë nënkuptojmë me përfshirjen e prindërve në punën dhe vendimarrjen në kopsht?	7
1.3. Përse është e rëndësishme përfshirja e prindërve?.....	9
1.3.1. Përfshirja e prindërve të fëmijëve në rrezik.....	10
1.4. Ide për përfshirjen e prindërve - shembuj nga praktika	11
2. Metodologjia – Përfshirja e prindërve në punën e kopshteve - si të ndërtohen raporte	13
2.1. Prindërit dhe si i perceptojmë ata.....	15
2.2. Nga t'ia filloni	18
2.2.1. Zhvillimi i besimit midis profesionistëve në ekip	20
2.3. Hartëzimi (Mapimi)	22
2.3.1 Përcaktimi i pengesave për përfshirjen e prindërve	24
2.4. Planifikimi	25
2.4.1. Përgatitja e një propozim deklarate për vizionin	28
2.4.2. Lista për kontroll për planifikimin e përfshirjes së prindërve në punën dhe vendimarrjen në kopsht.....	29
2.5. Vlerësimi.....	31
2.5.1. Anketat	32
2.6. Organizimi i takimeve në grup për prindër	34
2.6.1. Shqyrtoni nevojat	35
2.6.2. Formoni një grup.....	36
2.6.3. Gjatë takimit/punëtorisë.....	37
2.6.4. Rregulla temelore për profesionistët të cilët e udhëheqin grupin	38
2.7. Përfshirja e prindërve dhe e familjeve të fëmijëve në rrezik në punën e kopshteve.....	39
2.7.1. „Vegla“ për komunikim	40
2.7.2. Rekomandime plotësuese.....	42
2.8. Kur të shfaqen probleme.....	43
2.8.1. Prindërit nuk mund të marrin pjesë në takimet ose aktivitetet për shkak të konfliktit me oraret (për shembull, punë, familje, aktivitete fetare dhe shoqërore)	43
2.8.2. Çfarë nëse dështon grupi.....	44
2.8.3. Çfarë duhet të bëhet kur prindërit nuk do të vijnë në takime.....	44
2.8.4. Konflikte	45
2.8.5. Model për zgjidhjen e konflikteve	45
2.9. Strategji për zvogëlimin e rezistencës së prindërve.....	46
2.9.1. Pranojeni rezistencën.....	47
2.10. Informata kthyese	50
2.10.1. Dhënia e informatave kthyese	50
2.10.2. Pranimi i informatave kthyese	51
2.11. Bashkëpunimi nga distanca.....	52

3. Punëtoritë.....	55
3.1. UDHËZIME PËR MODERATORËT.....	55
3.2. AKTIVITETE HYRËSE	56
3.2.1. Jashtë kornizave	56
3.2.2. Unë në sytë e fëmijës.....	57
3.2.3. Njoftimi reciprok	58
3.2.4. Gjuetia e thesarit njerëzor	58
3.3. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PRINDËRVE PËR BASHKËPUNIM DHE PARTNERITET ME KOPSHTET PËR FËMIJË;	59
3.3.1. Çfarë është përfshirja e prindërve?.....	59
3.3.2. Përse është e rëndësishme përfshirja e prindërve?.....	60
3.3.3. Përmirësimi i bashkëpunimit midis kopshtit për fëmijë dhe familjes.....	61
3.3.4. Të drejtat dhe përgjegjësitë	61
3.3.5. Bashkëpunimi	62
3.4. FORMA TË NDRYSHME PËR PËRFSHIRJE TË PRINDËRVE/FAMILJEVE;.....	63
3.4.1. Çfarë mund të jetë përfshirje e prindërve?.....	63
3.4.1.1 Materiali: Tipologjia Epstein për përfshirjen e prindërve	64
3.4.2 Mbështetja e fëmijëve	64
3.4.3 Formimi i të ardhmes së kopshtit tonë	65
3.4.4. Dita e familjes: Marrja e vendimeve së bashku	65
3.5 INKURAJIMI I PËRSHIRJES SË BABALLARËVE	66
Shënimet e moderatorit.....	66
3.5.1. Roli i babait.....	67
3.5.2. Dikur dhe sot	67
3.5.3. Përgjegjësitë e ndara.....	68
3.5.4. Vlerat	69
3.5.4.1. Materiali - "Çfarë vlerësoj tek fëmija im"	69
3.5.5. Vizioni për babanë.....	69
3.5.6. Përfshirja	70
3.6 MBËSHTETJA SHITESË PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE NË RREZIK DHE TË CENUESHËM NGA PËRJASHTIMI.	70
3.6.1. Çfarë është për ju mbështetja?.....	70
3.6.2. Mësimi nga e kaluara	70
3.6.3. Angazhimi i prindërve për përfshirje.....	71
4. Kuptimi më i thellë i kompetencave relacionale	73
4.1. Kompetencat relacionale	74
4.2. Integriteti dhe bashkëpunimi	76
4.3. Përgjegjësia	77
4.4. Dinjiteti i barabartë	78
4.4.1. Komunikimi i njohjes.....	79
4.4.2. Gjuha personale	80
4.5. Prindërimi pozitiv	81

4.6. Komunikimi.....	83
4.5.1. Ligjet e komunikimit të Vaclavik-ut.....	83
4.7. Komunikimi i bazuar në zgjidhje	85
Shtojca: 1 Vetëvlerësimi i zhvillimit profesional	88
Shtojca: 2 Formular reflektues për zhvillimin profesional (për biseda individuale me prindërit).....	90
Shtojca 3: Vlerësimi për prindërit	91
Shtojca 4: Vlerësimi për profesionistët.....	92
<i>Shtojca 5: reflektimi kolegjal</i>	93
<i>Literatura:</i>	94

1. Doracak për profesionistët

1.1. Si shfrytëzohet ky doracak

Ky doracak është dedikuar për profesionistë të punësuar në institucione parashkollore dhe ka të bëjë me zhvillimin dhe nxitjen e përfshirjes së prindërve në punën dhe marrjen e vendimeve në arsimin parashkollor.

Ideja e këtij doracaku është t'u ofrojë praktikuesve njohuri të dobishme, bashkëkohore për përfshirjen e prindërve në punën e kopshteve, por gjithashtu edhe të ofrojë shumë më tepër se kaq. Jemi të sigurt se informatat dhe njohuritë e ofruara jo vetëm që do të kenë ndikim ndaj zhvillimit tuaj profesional, por konsiderojmë që do të jenë të dobishme edhe për zhvillimin tuaj personal.

Doracaku përbëhet prej katër pjesëve të lidhura ngushtë.

Në pjesën e parë, jemi përqendruar në **premisën themelore lidhur me atë se çfarë do të thotë të përfshihen prindërit në marrjen e vendimeve dhe në punën e kopshteve.**

Në pjesën e dytë të doracakut, theksi është te **udhëzimet praktike për ndërtimin e marrëdhënieve, të përfshirjes së prindërve në punën dhe marrjen e vendimeve në kopsht.** Në këtë pjesë janë përfshirë një sërë temash të cilat japin përgjigje ndaj pyetjeve të caktuara me të cilët profesionistët e fushës ballafaqohen për çdo ditë gjatë bashkëpunimit dhe ndërtimit të marrëdhënieve me prindërit në kopshte (për shembull nevoja për hartëzim, planifikim, komunikim me prindërit). Theks i veçantë i është vënë përfshirjes së prindërve dhe familjeve të fëmijëve në rrezik.

Në pjesën e tretë të doracakut është dhënë një **skenar për punëtoritë në temat vijuese: Të drejtat dhe obligimet e prindërve për bashkëpunim dhe partneritet me kopshtet për fëmijë; Mënyra të ndryshme për përfshirjen e prindërve/familjeve; Mundësi të barabarta të nënave dhe baballarëve për përfshirje; Nxitje e baballarëve për përfshirje; Mbështetje plotësuese për prindërit e fëmijëve në rrezik dhe të fëmijëve të cenueshëm ndaj përjashtimit.** Dizajni i programit parashikon zhvillimin e skenarëve për punëtorin, materialeve, fletushkave dhe doracakëve për pjesëmarrje të prindërve në përmbajtjen e punëtorisë.

Në pjesën e katërt i **prezantojmë bazat teorike të punës me prindër.** Dokumenti bazohet në konceptet teorike të lidhura me kompetencat për arritjen e marrëdhënieve të mira ndër njerëzore, të përkufizuara nga ana e Jul dhe Jensen, me dy plotësime të rëndësishme: Parimet e Adlerit për të kuptuarit e shkakut kryesor për sjelljen dhe terapinë e orientuar drejt zgjidhjeve. Konsiderojmë që qasjet e këtyra plotësohen dhe sigurojnë një qasje relevante dhe kohezive ndaj punës me prindërit. Po ashtu ofrojmë edhe një listë të pasur të literaturës plotësuese e cila mund të ju shërbejë për humtim të mëtejshëm më të thellë të temës.

Të gjithë kapitujt mund të lexohen si të veçanta, por ashtu siç do të lexoni, do të vëreni se ato plotësojnë njëri-tjetrin dhe formojnë një tërësi të nevojshme për ngritje të suksesshme të marrëdhënieve me prindërit.

Një pjesë e madhe e kapitujve përmbajnë porosi për “memorizim” në formë të fjalive të shkurta të cilat mund të përdoren nga ana e profesionistëve për t’u përkujtuar për parimet e përshkuara në doracak. Një pjesë e kapitujve përmbajnë pyetje për mendim, si dhe rekomandime nga literatura përkatëse, video ose artikuj frymëzues.

Ne e vlerësojmë shumë zhvillimin e mendimeve të praktikuesve meqenëse e dimë se pikërisht pyetjet që nxisin të menduarit na ndihmojnë të nxjerrim mësim nga përvoja jonë praktike personale, t’i perceptojmë sfidat nga një këndvështrim i ri dhe t’i zhvillojmë kompetencat tona profesionale. Një pjesë të pyetjeve mund t’u përgjigjeni bashkërisht me kolegët tuaj ose individualisht. Sidoqoftë, konsiderojmë se do të nxirrni përfitim dhe frymëzim nëse do të përpiqeni të zbatoni një pjesë të njohurive të ofruara në praktikë.

Një pjesë e konsiderueshme e doracakut është orientuar drejt zhvillimit të praktikës refleksive të profesionistëve me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe vetëbesimit të tyre si edukatorë. Kjo, nga ana tjetër kontribuon në zhvillimin e tyre profesional dhe nxit bashkëpunim dhe përfshirje më të mirë të prindërve në punën dhe proceset e vendimmarrjes në kopsht.

Lexuesve u rekomandojmë ta lexojnë të gjithë doracakun që të fitojnë njohuri për tërësinë dhe të mësojnë për bazat mbi të cilat shtrihen punëtoritë për prindërit. Gjatë leximit të mëtejshëm dhe gjatë zbatimit praktik të punëtorive të propozuara, lirisht mund të shfrytëzoni kapitullin i cili ju nevojitet.

Nëse sapo keni filluar të ecni në shtegun e përfshirjes së prindërve në punën e kopshtit ose dëshironi të ndryshoni mënyrën e tanishme të ndërtimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit me prindërit, bëhuni të butë dhe përgjegjës ndaj vetes suaj dhe filloni me aktivitete të cilat ju duken më të thjeshta dhe më të afërta me mënyrën në të cilën aktualisht punoni në praktikë. Vendosni qëllime të arsyeshme dhe të matshme. Mos pritni shumë nga vetja. Ndërtimi i marrëdhënieve dhe përfshirja e prindërve në punën dhe marrjen e vendimeve në kopsht paraqet një proces i cili ka ngritjet dhe rëniet e veta dhe i cili kërkon kohë. Për fillim, parimi hap pas hapi paraqet një bazë të mirë.

1.2. Çfarë nënkuptojmë me përfshirjen e prindërve në punën dhe marrjen e vendimeve në kopsht?

Përfshirja e prindërve mund të përkufizohet si pjesëmarrje e prindërve në zhvillimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre që nga lindja, duke pas parasysh faktin që ata janë ndikimi kryesor ndaj jetës së fëmijëve.

Prindërit dhe praktikuesit japin një kombinim unik të elementeve të arsimit parashkollor. Prindërit kanë njohuri për situatën në shtëpi, familjen e tyre më të gjerë, për personat e rëndësishëm në jetën e fëmijëve të tyre, si dhe për kulturën, shëndetin, historinë, vështirësitë dhe çështjet e lidhura me fëmijën!

Praktikuesit kanë njohuri për nevojat e të gjithë fëmijëve në arsimin parashkollor, për zhvillimin fëmijëror dhe mësimin, për aktivitetet në kuadër të programeve mësimore dhe për marrëdhëniet me bashkëmoshatarët.

Gjatë hartimit të procesit të përfshirjes së prindërve dhe vendosjes së qëllimeve, duhet të merren parasysh gjendja aktuale e kopshteve dhe qëllimet e aktiviteteve tjera programore me qëllim që të

harmonizohen mes vete. Duhet të merren parasysh qëndrimet, përvojat dhe pritjet e të gjithë subjekteve të përfshirë në proces, gjatë vendosjes së qëllimeve dhe vlerësimit të realizimit të tyre. *Më tepër për procesin e hartëzimit dhe planifikimit të përfshirjes së prindërve mund të lexoni në pjesët 2.3 dhe 2.4.*

Kopshti duhet të sigurojë që profesionistët dhe prindërit të kenë mundësi formale dhe joformale për komunikim dhe këmbim të informatave për fëmijët. **Përfshirja e prindërve është një praktikë e planifikuar në mënyrë sistemore në kopshtin për fëmijë, që do të thotë se kopshti ka obligim të përcaktojë dhe ndërtojë mundësi dhe të fillojë procese kontekstuale relevante për vendosjen e programeve të cilat i përfshijnë prindërit në arsimimin e fëmijëve të tyre, si dhe prioritetet dhe aktivitetet më të gjera në kopsht.**

Edhe pse mundësitë formale mund të jenë shumë të dukshme (për shembull: takime me prindërit), sidoqoftë duhet të kushtohet vëmendje përkatëse edhe ndaj krijimit të ndërveprimit joformal me prindërit dhe mund të fillohet me diçka themelore siç është për shembull të ndjehen të mirëseardhur në atë mjedis.

Për shembull:

- Të vendosen shenja me mbishkrimin 'mirëserdhët' rreth kopshtit;
- Praktika gjithëpërfshirëse të pranimit në 'hyrje', përfshi edhe personel dygjuhësor, respektivisht informata dhe procedura të shkruara në më tepër gjuhë.

Praktikuesit duhet të sigurojnë që komunikimi i këtyre e mbështet mësimin dhe zhvillimin e fëmijës dhe se i njëjti mund të arrihet me përfshirjen e prindërve. Shembujt për llojin e këtyre të punës i përfshijnë gjërat në vijim:

- Sisteme dhe procese të zhvilluara që prindërit të kenë qasje të përditshme deri në informata për sjelljen e fëmijës së tyre, zhvillimin e tij, etj., përmes një sërë mediash të cilat prindërit dinë ti përdorin dhe të cilat u mundësojnë prindërve t'i kuptojnë informatat.
- Politikat e brendshme për moshën parashkollore të jenë shkruar në këshillim me prindërit.
- Informatat kthyes nga prindërit të jenë të inkuorporuar në planin vjetor dhe të ndikojnë në hartimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve të ardhshme.
- Strategjitë për mbështetje të fëmijëve akordohen, harmonizohen dhe zbatohen me prindërit

dhe lloje të ndryshme të takimeve, komunikimeve me shkrim, prindër në kopshte fëmijësh, kontakte në shtëpi, etj.

Për fillim, do të ishte e dobishme të qartësohet përkufizimi 'prind'. Zakonisht, e kemi të njohur përkufizimin për prindërit i cili përfshin nëna, baballarë, kujdestarë ligjor, si dhe dhënësit kryesor të kujdesit për fëmijët.

Në praktikë, profesionistët e dinë se mund të ketë edhe persona tjerë të rëndësishëm në jetën e fëmijës, për shembull gjyshja apo gjyshi. Këto persona të rritur mund të kalojnë kohë të gjatë me fëmijën, të zhvillojnë marrëdhënie të dashurisë reciproke dhe të konsiderohen si përgjegjës për fëmijën. Nganjëherë, këto persona janë kontakti kryesor me familjen e fëmijës dhe janë në gjendje t'ua tregojnë profesionistëve shumë gjëra për mjedisin shtëpiak të fëmijës.

Në këtë doracak, përkufizimi „prindër“ u referohet prindërve biologjik, birësuesve, njerku dhe njerka, si dhe dhënësit kryesor të kujdesit siç janë gjyshet dhe gjyshërit, anëtarë tjerë të moshuar të familjes dhe prindër kujdestarë. Familjet mund të jenë biologjike dhe jo biologjike, të zgjedhur ose të përfitur. Ata janë të lidhur përmes kulturave, gjuhëve, traditave, përvojave të përbashkëta, përgjegjesisë emocionale dhe mbështetjes reciproke.

Mirëpo, **në kuptimin juridik**, ekziston dallim potencial midis asaj se kush mund të konsiderohet prind të fëmijës së caktuar dhe kush e ka përgjegjësinë ligjore për shëndetin, arsimimin, etj., të fëmijës. Pikërisht për këtë arsye është shumë e rëndësishme të dihet e drejta familjare dhe të njihet baza nga ligji për familjen e cila lidhet me ushtrimin e të drejtave prindërore.

Praktikuesit shpeshherë ballafaqohen me pyetjen lidhur me atë se me cilin duhet të bashkëpunojnë, respektivisht me kë duhet të bisedojnë për mësimin, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës. Ndoshta nuk ka një përgjigje të caktuar të përgjithshme dhe të qartë për këtë pyetje, respektivisht mund të ekzistojnë një sërë rregullimesh të ndryshme. Me rëndësi është të merret parasysh se vetëm prindërit me përgjegjësi prindërore mund të nënshkruajnë formularë për pëlqim, duhet të japin pëlqim që dikush tjetër t'i merr fëmijët e tyre nga kopshti, respektivisht të sjellin vendime përfundimtare për arsimimin, shëndetin, etj., të fëmijës.

Mund të arrini marrëveshje me prindërit, për shembull, që gjyshja do ta sjell dhe do ta merr fëmijën nga kopshti. Edhe pse gjyshja luan rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe mësimin e nipit të saj, papëseparapë duhet të gjeni mënyrë për përfshirjen e prindërve në kopsht.

Për nevojat e këtij doracaku dhe bashkëpunimit praktik me prindërit, do të shfrytëzojmë një përkufizim më të gjerë të përkufizimit 'prindër' nga ajo që buron nga kuptimi i përgjegjesisë prindërore dhe për këtë arsye në këtë përkufizim po ashtu do t'i përfshijmë edhe personat tjerë të moshuar të rëndësishëm në jetën e fëmijës. Po ashtu, kur flasim për familjet, kemi parasysh lloje nga më të ndryshmet të familjeve.

Rekomandim: *Dr. Karen Man për angazhimin e prindërve dhe familjes në arsim*
<https://www.youtube.com/watch?v=5YXH8VfZ89Y>

1.3. Pse është e rëndësishme përfshirja e prindërve?

Familja dhe institucioni arsimor janë dy kontekstet më të rëndësishme të cilat ndikojnë ndaj zhvillimit dhe mësimin të fëmijëve përmes komunikimit dy-drejtimesh dhe llojeve të ndryshme të rregullimeve nga të dyja anët.

- Prindërit janë edukuesit kryesor të fëmijëve
- Prindërit dhe profesionistët të cilët punojnë në partneritet, kontribuojnë për mirëqenien e fëmijëve
- Përfshirja e prindërve paraqet mbështetje të prindërimit
- Përfshirja e prindërve paraqet mbështetje afatgjate të komunitetit.

Në këtë kuptim, profesionistët në institucionet për arsim të hershëm fëmijëror dhe kujdes për fëmijët duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e përfshirjes së prindërve dhe të kenë parasysh „të vërteta“ të caktuara për përfshirjen e prindërve:

1. Të gjithë prindërit kanë shpresë dhe qëllime për fëmijët e tyre. Dallimet kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën i mbështesin përpjekjet e fëmijëve të tyre për arritjen e këtyre qëllimeve;

2. Mjedisi familjar është një nga disa mjedise që prekin fëmijën në të njëjtën kohë. Me qëllim të realizimit të mirëqenies së fëmijëve, është e nevojshme që institucioni të bashkëpunojë me mjediset tjera;
3. Prindi është pjesëmarrësi kryesor në edukimin dhe arsimimin e fëmijës, por megjithatë institucionet arsimore mund t'i përforcojnë kompetencat e tyre prindërore;
4. Përfshirja e prindërve duhet të jetë element legjitim në arsim. Ajo meriton theks të barabartë si edhe elementet tjera siç janë përmirësimi dhe vlerësimi i programeve;
5. Përfshirja e prindërve është proces, dhe jo një program aktiviteteve. Ajo kërkon përkushtim dhe energji e vazhdueshme;
6. Përfshirja e prindërve kërkon vizion, politika dhe një kornizë. Konsensusi është shumë i rëndësishëm;
7. Ndërveprimi i prindërve me fëmijët e tyre paraqet gur themel të përfshirjes së prindërve. Programi duhet të njoh vlerën, shumëllojshmërinë dhe peshën e këtij roli;
8. Pengesat për përfshirje të prindërve qëndrojnë në praktikën/format e përcaktuara të ndikimit në institucion. Ata nuk janë të vendosura nga ana e prindërve;
9. Prindërit mund të jenë „vështirë të kapshëm“. Prindërit duhet të identifikohen dhe të qasen individualisht. Ata nuk janë të përkufizuar sipas përkatësisë së tyre gjinore, etnike, gjendjes civile, arsimimit ose të ardhurave;
10. Përfshirja e suksesshme e prindërve nënkupton kultivim të marrëdhënieve dhe partneriteteve të cilat i fuqizojnë lidhjet midis shtëpisë dhe shkollës, prindërve dhe praktikuesve, prindërve dhe shkollës, shkollës dhe komunitetit.

Rekomandim: *Angazhimi i prindërve me dr. Debi Pushor.*
<https://www.youtube.com/watch?v=jyP3NpCOBIM>

1.3.1. Përfshirja e prindërve të fëmijëve në rrezik

Qëllimi i përfshirjes së prindërve në punën e kopshteve, mes tjerash është me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të fëmijës. Kur flasim për përfshirjen e prindërve të fëmijëve në rrezik, e dobishme është të merren parasysh 3 nivele të mbështetjes të përmbushura përmes përfshirjes në varësi nga nevojat e familjeve dhe komuniteteve.

1. **Mbështetja universale** e siguar përmes aktiviteteve dhe shërbimeve që janë më se të domosdoshme dhe të dobishme për familjet e fëmijëve të rinj. Është e hartuar të jetë e dobishme për të gjithë familjet, kujdestarët dhe fëmijët. Informatat dhe burimet janë përshtatur ndaj moshës së fëmijës dhe rrethanave në familje. Mbështetja universale duhet të jep udhëzime themelore dhe mbështetje në situata të përditshme, si dhe në çaste kur ekzistojnë sfida, respektivisht probleme.
Për shembull: mbledhje prindërore, panele informative të qasshme, aktivitete vullnetare në të cilat marrin pjesë prindërit...
2. **Mbështetja e synuar** përqendrohet te familjet dhe fëmijët të cilët janë të prekur nga rreziqe siç janë varfëria, migrimi, sëmundjet, dhuna, gjendje të jashtëzakonshme humanitare, etj. Qëllimi është që fëmijët, prindërit dhe familjet të ndjehen të mirëseardhur në kopsht, të zvogëlohet efekti negativ i rrezikut ndaj të cilit është ekspozuar familja dhe të fuqizohen kapacitetet e tyre për ballafaqim me rreziqet e tilla.
Shembull: informata në faqe interneti të përkthyer në gjuhët e pakicave kombëtare, përdorimi i terminologjisë së saktë për gjendje, respektivisht grupe të caktuara, përdorimi i foto-

grafive në panelet informative për prindërit analfabet, kafene për bashkëbisedime me prindërit...

- 3. Mbështetje e indikuar.** Shërbime të specializuara për familje, respektivisht fëmijë me nevoja të përcaktuara. Ky lloj i mbështetjes zakonisht sigurohet nga ana e ekspertëve të fushave të ndryshme në kopsht (shërbime këshillimore në kopsht), respektivisht institucioni ose organizata në komunitetin lokal. Nëse mbështetja e këtillë në kopsht sigurohet në grup, atëherë duhet të jetë punë ekipore e personave profesional të fushave të ndryshme (për shembull: edukator, punonjës social, psikolog)

Është e rëndësishme të mbani në mend!

Të gjithë fëmijët dhe familjet duhet të kenë qasje deri te mbështetja universale përmes praktikave dhe aktiviteteve të planifikuara sistemore për përfshirje të prindërve në punën e kopshteve për fëmijë.

Por, familjet dhe prindërit e fëmijëve në rrezik, po ashtu kanë **nevojë për ndihmë plotësuese** nga shërbimet profesionale në kopsht.

Prandaj, a duhet ata të pranojnë mbështetje universale apo shërbime të specializuara? Përgjigja është "të dyja"!

Fëmijët, prindërit dhe familjet asnjëherë nuk duhet të përjashtohen nga ndihma universale, sepse nuk ekziston kufi i ashpër midis fëmijëve, prindërve dhe familjeve të cilët shfrytëzojnë ndihmë universale dhe atyre që kanë nevojë për mbështetje plotësuese.

Punoni në ekipe dhe vlerësoni me kujdes kujt duhet t'i sigurohet mbështetje e përshtatur për familjet e cënueshme dhe bëjeni atë lehtësisht të qasshme.

Gjithmonë duhet të shfrytëzohen shërbimet universale, meqë madje edhe me qëllimin më të mirë disa herë mbështetja e synuar mund të nxis, respektivisht të sjell deri në fuqizimin e stigmës dhe përjashtimit social.

Aktivitete reflektuese në grup:

Si e kuptojnë familjet me të cilët punoni pjesëmarrjen e tyre në jetën e kopshtit për fëmijë?

Si e kuptojnë kolegët tuaj pjesëmarrjen e prindërve/familjeve?

Si e inkurajon (ose jo) institucioni i juaj pjesëmarrjen e këtillë?

Cilat masa mund t'i shfrytëzojnë profesionistët për nxitjen e pjesëmarrjes së të gjithë familjeve në jetën e institucionit?

Cilat janë pengesat për pjesëmarrje të familjeve?

A ka familje me pjesëmarrje më të mirë? Pse?

A ka familje që asnjëherë nuk kanë marrë pjesë? Pse?

Deri në çfarë shkalle këto dallime ndërlidhen me llojllojshmërinë e tyre sociale dhe kulturore?

Si planifikojnë edukatorët strategji për tejkalim të këtyre vështirësive?

Si i angazhoni ata prindër që janë 'vështirë të kapshëm'?

Si angazhoheni së bashku me komunitetin për krijimin e lidhjeve më të fuqishme për përfshirje të prindërve?

1.4. Ide për përfshirjen e prindërve - shembuj nga praktika

Jo gjithmonë është lehtë të prezantohet në mënyrë të thjeshtë, çfarë saktësisht paraqet përfshirja e prindërve. Kjo nuk mund të realizohet pa u marrë parasysh politikat ekzistuese arsimore, rrjeti institucional dhe dinamika e brendshme, si dhe (pa) kapshmëria e familjeve, struktura e tyre dhe baza kulturologjike.

Megjithatë, ajo që mund ta bëjmë është të kemi parasysh se pjesëmarrja e prindërve në punën e kopshtit duhet të përfshijë nivele të ndryshme të përfshirjes, edhe atë:

Informimi - (për shembull: njoftim për ngjarjet rrjedhëse, raporte dhe kontakte ditore me prindërit).

Këshillimi - (për shembull: biseda me prindërit për gjithçka, e jo vetëm për situatat problematike).

Vendimmarrja e përbashkët - (për shembull: mbledhjet prindërore, grupet për bashkëbisedim, këshillat e prindërve ...)

Aktivitetet e përbashkëta - (për shembull: aktivitete në grup të prindërve, aktivitete vullnetare në kopsht, aktivitete të përbashkëta në komunitetin lokal).

Ose mund të mendoni në drejtim të aktiviteteve të ndryshme:

- **Kontakti i përditshëm.** Prindërit dhe edukatorët duhet të shkëmbejnë informata me familjet për çdo ditë, nga dita e parë e qëndrimit të fëmijës. Zhvillim i strategjive (tabela e shpalljeve, fletore/ditar për mësim në shtëpi, grupe në viber), organizim i brendshëm i transmetimit të informatave nga ana e edukatorit në grup dhe nga personi i obliguar për lëshim të fëmijëve), lehtësim i këmbimit kur arsimtari nuk mund të bisedojë me të gjithë familjet. Duhet menduar për riorganizimin e ritmit të ditës në pajtim me nevojat e familjes.
- **Takime me prindërit "ballë për ballë".** Shmangni takimet të cilat mbahen vetëm në rast të konfliktit ose vetëm gjatë fillimit dhe fundit të vitit shkollor. Shfrytëzoni ata për t'u lidhur me prindërit, për të qenë kureshtar për jetën e fëmijës, respektivisht për të ndarë informata për fëmijën dhe për t'u njohur me secilën familje veç e veç. Lehtësojuni prindërve organizimin e takimeve. Bëhuni të hapur për mundësitë e takimeve onlajn (Skype, Zoom...) me të punësuarit. Në qoftë se prindi jep pëlqim, takimet mund të xhirohen dhe t'u dërgohen prindërve, ndërsa xhirimi mbetet në arkivin tuaj.
- **Takime në grup.** Duhet të shmanget modeli i njëanshëm, në të cilin edukatori është pjesëmarrësi i vetëm i cili flet. Takimet në grup mund të shfrytëzohen për njohje me prindërit, për transmetim të informatave, hartëzim të nevojave të prindërve, planifikim, ndërlihdje të prindërve me çështje, sfida të njëjta, etj.
- **Përfshirja në aktivitetet e grupeve parashkollore.** Prindërit dhe familjet mund të marrin pjesë në punën e kopshtit për fëmijë gjatë procesit të përshtatjes, në punëtori, shëtitje shkollore, fjalime, mëngjese të përbashkëta, klube për lexim librash, aktivitete vullnetare, shkuarje në park, aktivitete në të cilat „prindërit më me përvojë u ndihmojnë prindërve me më pak përvojë“...
- **Përfshirja e prindërve në kopshtin për fëmijë dhe organizimin e tij.** Bashkëpunim në një nivel më formal përmes pjesëmarrjes në ekipet dhe trupat e kopshtit për fëmijë (këshilli i prindërve, këshilli i drejtorëve)

- **Përfshirja në aktivitete të përbashkëta në komunitetin lokal** - mbështetje, respektivisht pjesëmarrje vullnetare në aktivitete të organizuara nga institucioni ose në organizim të komunitetit lokal
- **Vizita shtëpiake** - Për shembull vizitë e lagjes ku jeton fëmija, nga ana e tërë grupit (për shembull: kur ka një fëmijë të ri në grup) ku prindi mund të jetë „udhërrëfyes“ nëpër lagje ose po vizitat mund të jenë këshilluese dhe informative për prindërit në përputhje me nevojat e tyre.

Në lidhjet e mëposhtme mund t'i shihni idetë e ndryshme për përfshirje të prindërve në punën e kopshtit.

Programi “vitet e pabesueshme” dhe ndërhyrjet që ndërlidhem me të paraqesin një sërë programesh të përqendruara në fuqizimin e kompetencave prindërore dhe nxitjen e përfshirjen së prindërve. Programet prindërore janë të grupuara sipas moshës.
<https://incredibleyears.com/>

Qëllimet e projektit A PAR janë promovimi i zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijëve dhe familjeve të tyre, parandalimi dhe lufta kundër problemeve arsimore dhe sociale që nga lindja.
<https://a-par.org/>

Doracaku për angazhimin e familjes është një përmbledhje e qasjeve të bazuara në hulumtim të cilat premtajnë fuqizim të kompetencave të personave, grupeve dhe organizatave të cilat i janë përkushtuar familjes. Doracaku ofron ide, modele dhe vegla të cilat lehtë mund të integrohen në trajnime, arsimimin e vazhdueshëm dhe mundësitë organizative për mësim.
<https://medium.com/familyengagementplaybook/approaches/home>

2. Metodologjia - përfshirja e prindërve në punën e kopshteve - si të ndërtohet marrëdhënia

Mbani në mend: *Marrëdhëniet janë rrugë me dy kahje.*

Rekomandime: Dr. Tim Mur: Angazhimi autentik - Rroli i marrëdhënieve në thelbin e praktikës efektive

<https://www.youtube.com/watch?v=AKvRXvXTZ6w&t=170s>

Qasja e përfshirjes së prindërve i përshkruar në këtë doracak bazohet në rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve midis prindërve dhe profesionistëve. Në doracak jemi përqendruar në **zhvillimin e kompetencave relacionale** në marrëdhëniet pedagogjike.

Kompetencat për zhvillimin e marrëdhënieve të mira ndër njerëzore janë: *„Gatishmëria dhe vullneti i profesionistit të „sheh“ personin tjetër (fëmijë, prind) ashtu siç është, si dhe të përshtat në mënyrë përkatëse sjelljen e tij pa hequr dorë nga lidhshipi, si dhe aftësia për të qenë i sinqertë gjatë kontakteve me fëmijën. Pos kësaj, profesionisti duhet tërësisht të ndërmerë përgjegjësinë për cilësinë e marrëdhënies.“* (Jul dhe Jensen, viti 2014)ⁱⁱ.

Më tepër informata për zhvillimin e shkathtësive për zhvillimin e marrëdhënieve janë dhënë në Kapitullin 4.

Modeli i bazuar në marrëdhëniet për përfshirjen e prindërve në punën e kopshtit për fëmijë paraqet **zhvendosje të përqendrimit nga modeli ekspert** të marrëdhënieve prototip me familjet në **modelin përdorues**.

MODELI EKSPERTË	MODELI SHRYTËZUES
Profesionisti është ekspert dhe ai i sjell vendimet. Përfshirja fillon me dërgimin e porosisë prindërve. Prindërve nuk ka nevojë t’u jepet më tepër shpjegime meqenëse profesionisti është eksperti.	Edhe prindërit edhe profesionistët i japin njohuritë e nevojshme. Përfshirja fillon me atë që dëgjohej se çfarë kanë për të thënë prindërit. Përqendrimi është te partneriteti dhe dialogu midis profesionistëve dhe prindërve.
Kontaktet janë të pakta dhe në nivel teknik - përdoret terminologji profesionale (e cila është e vështirë për t’u kuptuar për prindërit dhe për familjet). Profesionistët zakonisht vendosen në nivel më të lartë.	Marrëdhënia bazohet në barazi, meqë çdokush është ekspert ose për njohjen e fëmijës ose për mundësitë dhe alternativat arsimore.
Këndvështrimi i prindërve nuk merret parasysh dhe profesionistët konsiderojnë se duhet t’u tregojnë prindërve si të sillen me fëmijët dhe si t’a organizojnë jetën familjare.	Ekziston dialog me qëllim të arritjes së pëlqimit të dhe gjetjes së zgjidhjeve.
Të bëhet DERI dhe PËR prindërit. Të sigurohen programe për familjet.	Bëni (bashkë-krijoni) me prindërit. Ndërtimi i marrëdhënieve me prindërit dhe familjet:

	Parashtroni pyetje, dëgjoni, fuqizoni, ndani këndvështrime dhe informata, krijoni partneritet, bashkë-hartoni, zbatoni, merrni rreziqe, mbështetni prindërit ... Inkurajimi i familjeve të eksperimentojnë me praktika të reja.
--	--

Sipas kësaj, në këtë doracak, lidhur me përfshirjen e prindërve në punën dhe sjelljen e vendimeve në kopshtin për fëmijë do të përqendrohemi te prindi, shërbimet profesionale dhe te elementi i tretë, respektivisht marrëdhëniet e tyre reciproke. Në Kapitullin e katërt të këtij doracaku janë shqyrtuar më hollësisht kushtet për ndërtim të marrëdhënieve me prindërit.

PRIND ↔ PROFESIONIST

MARRËDHËNIE

Në këtë qasje, profesionistët mund t'i individualizojnë aktivitetet dhe strategjitë për komunikim në pajtim me gjendjen jetësore, kulturën, gjuhët, bindjet, vlerat, praktikën, traditat dhe anët e forta të familjeve të çdonjërit nga fëmijët. Përfshirja efektive e familjes nënkupton **marrjen e një perspektive të bazuar në pikat e forta që identifikohet dhe ndërtohet mbi aftësitë dhe cilësitë pozitive të secilës familje.**

Profesionistët duhet të bashkëpunojnë me prindërit që t'i përcaktojnë anët e forta të familjes dhe burimet e nevojshme për tejkalimin e sfidave dhe arritjen e qëllimeve familjare. Këto burime mund të jenë të qasshme në kuadër të familjes, rrjeteve sociale, fqinjësi ose komunitet dhe mund të përfshijnë organizata të udhëhequra nga prindërit, respektivisht organizata tjera apo institucione të komunitetit lokal.

Kur marrëdhëniet përfshijnë respekt dhe besim të ndërsjellë, edukatorët mund të mësojnë së bashku me prindërit për atë se si mirëqenia e familjes ndikon ndaj mundësisë së fëmijës së tyre për t'u ndjerë i sigurt, mbrojtur dhe i interesuar për mësim.

Nganjëherë faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë ndaj cilësie dhe shpeshësisë optimale të marrëdhënieve.

- Nganjëherë në mesin e profesionistëve ekziston stigmë se prindërit janë të vështirë për bashkëpunim.
- Vendosija e marrëdhënieve me prindërit mund të konsiderohet për diçka që është e shkallës së dytë në kuadër të kulturës së kopshtit për fëmijë.
- Shumë nga profesionistët me kompetencë të lartë janë kompetentë për punë me fëmijë dhe mund të ballafaqohen me marrëdhënie me prindërit të cilat paraqesin sfidë.
- Marrëdhëniet familjare dhe shkollore janë të ndërlikuara dhe përfshijnë faktorë emotiv dhe zakonisht janë me pritje shumë të vogla ose me aspak pritje nga ana e të dy kategorive të faktorëve.
- Mungesa e shkathtësive sociale dhe emocionale te profesionisti.

Pjesa më e madhe e ndërveprimeve midis arsimtarëve, respektivisht ofruesve të kujdesit për fëmijë, nga njëra anë dhe familjeve nga ana tjetër, linden gjatë periudhave të shkurta në fillim dhe mbarim të ditës, në çaste të ndarjeve dhe takimeve të sërishme. Ndërveprimet e këtilla, edhe pse disa herë të përshpejtuara prapëseprapë paraqesin mundësi të rëndësishme për përfshirje të prindërve dhe për ndërtim të marrëdhënieve. Pikërisht atëherë duhet të shkëmbehen vëzhgime dhe rrëfime për fëmijën, të shkëmbehen informata praktike dhe të vëzhgohen aktivitetet dhe rutinat ditore.

Takimet më të gjata, të planifikuara, siç janë takimet midis arsimtarit/kujdestarit të fëmijës dhe prindit po ashtu luajnë rol të madh lidhur me nxitjen e përfshirjes së prindërve në programet për zhvillim të hershëm fëmijëror. Me atë që do të sigurohen që familjet ndjehen të mirëseardhur dhe të përfshirë në mënyrë aktive në vendimmarrje, arsimtarët dhe përkëdhelësit e fëmijëve mund të bashkëpunojnë me familjet si partnerë të vërtetë.

Çdo kopsht për fëmijë dhe çdo grup ka specifikën e vetë, dhe përvojat me forma të ndryshme të përfshirjes mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, prandaj zbatimi kërkon njohuri dhe kuptim të koncepteve thelbësore, sfondit të tyre teorik, por edhe kontekstit të popullatës parashkolllore dhe prindërore dhe nevojave të tyre.

Propozojmë që ju, si profesionist në kopshtin për fëmijë të ndiqni këtë doracak nga afër, por në të njëjtën kohë, theksojmë se si ndjeshmëria e lehtësuesit të grupit specifik të prindërve, ashtu edhe ndërgjegjësimi për nevojat apo vështirësitë specifike në grup, si dhe përshtatja dhe ndjeshmëria ndaj kontekstit dhe situatës specifike janë faktorë vendimtarë për një bashkëpunim të suksesshëm me prindërit.

NDJESHMËRIA JUAJ, REAGIMI, ELASTICITETI DHE GATISHMËRIA JUAJ PËR BASHKËBISEDIM ME PRINDËRIT JANË PËRBËRËSIT „TË DOMOSDOSHËM“ MË TË RËNDËSISHËM AKTIV.

2.1. Prindërit dhe pikëpamjet tona për ta

Mënyra në të cilën profesionistët me apo pa vetëdije i shohin prindërit, ndikon ndaj cilësisë së marrëdhënieve të cilat i ndërtojnë me ta.

Bindjet e profesionistëve lidhur me prindërit, zakonisht janë profeci të cilat përmbushen veten e tyre.

Për të qenë në gjendje të zhvillonin marrëdhënie konstruktive me prindërit në kopshtin e fëmijëve, është e rëndësishme të mos i paragjykoni ata, por të keni një mendje të hapur për mënyrën e tyre të jetës familjare dhe stilin e tyre të prindërimit.

Ka shumë mënyra të ndryshme në të cilat individët dhe familjet mund të bëjnë një jetë cilësore që ofron një mjedis mbështetës për zhvillimin e një fëmije. Këto mënyra ndoshta dallojnë nga mënyrat me të cilat jemi mësuar.

Profesionistët inkurajohen të mendojnë për çdo fëmijë si një individ unik. Të njëjtat parime duhet të zbatohen për prindërit dhe familjen e tij - ata janë po aq unikë sa është fëmija.

Nëse ndahet mjaftueshëm kohë për të njohur prindër individualë, interesat, shqetësimet dhe idetë e tyre do t'ju pengojë t'i stereotipizoni ata, si dhe të siguroheni që ata të ndihen më të vlerësuar dhe të respektuar. Kjo, nga ana tjetër, do të vendosë bazat për një partneritet efektiv të punës.

Kur mendojmë për besimet tona, stereotipat dhe paragjykimet për prindërit me të cilët punojmë, është e rëndësishme të kuptojmë se ne të gjithë i kemi ato. Ato janë pjesë e përvojës njerëzore. Disa prej tyre mund të lidhen me fenë, identitetin kombëtar, kulturën prindërore, sëmundjen, mënyrën e jetesës, profesionin etj.

Për shembull, për disa edukatorë është jashtëzakonisht e vështirë të krijojnë një marrëdhënie bashkëpunimi me prindërit me profesion edukatorë për shkak të paragjykimet se do t'i vlerësojnë ata. Ose të punojnë me prindër të vetëm sepse u vjen keq për ta.

Stereotipat më të shpeshta në lidhje me përfshirjen e prindërve në punën e kopshteve kanë të bëjnë me besimin se prindërit nuk janë të interesuar të marrin pjesë në punën e kopshtit, se nuk kanë kohë për të marrë pjesë ose nuk janë të interesuar për rolet drejtuese. Është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm dhe të rishikoni pikëpamjet tuaja.

Profesionistët shpesh mund të kenë pritshmëri të rrejshme dhe të presin shumë nga familjet. Ata mund të mendojnë se të gjitha familjet mund dhe duhet të bashkëpunojnë dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë; ose presin që familjet të bëhen dhe të veprojnë si profesionistë në shtëpi, të "punojnë" me fëmijën e tyre, etj.

Ndonjëherë profesionistët mund të përfshihen shumë emocionalisht. Është e rëndësishme që të bashkë ndjeni me prindërit dhe familjet, por ekspertiza profesionale duhet të mbizotërojë gjithmonë;

Marrëdhëniet e mira dhe përfshirja e prindërve nuk do të thotë që të bëheni mik me prindërit apo të merrni rolin e një psikologu, këshilltari apo edhe të një pediatri.

Kufijtë e shëndetshëm të rolit profesional sjellin siguri dhe parashikueshmi të marrëdhënieve.

Besimi se prindërit duan më të mirën për fëmijët e tyre, por që nuk janë gjithmonë të aftë për ta bërë këtë, është një pikënisje e mirë për të punuar me prindërit.

Megjithatë, duhet të jeni të vetëdijshëm se vetëm një qëndrim i hapur ndaj prindërve dhe familjeve nuk do të shpie në përfshirjen e suksesshme të prindërve në punën dhe vendimmarrjen në institucionin parashkollor. Proceset profesionale të bashkëpunimit dhe bisedës kërkojnë një kombinim të vetë-reflektimit, njohurive shkencore dhe këndvështrimeve të reja.

Po ashtu është interesante të shihet se si prindërit i shohin profesionistët dhe si do të donin të trajtohen nga ana e profesionistëve në kopshte.

- Prindërit duan dikë që kujdeset për to dhe për fëmijët e tyre.
- Prindërit duan respekt dhe të shihen si element efektiv i ekipit arsimor të fëmijës së tyre.
- Prindërit duan të kenë pjesë në formimin e agjendës e cila i tangon.
- Ata duan të shohin që idetë e tyre respektohen dhe përdoren për krijimin e një mjedisi me kujdes cilësor për fëmijën.
- Prindërit duan profesionistë të aftë për zhvillim të hershëm fëmijëror të cilët e kryejnë këtë në mënyrë efektive dhe në mënyrë e cila vërtetë i kënaq nevojat e tyre.
- Prindërit duan të jenë pjesë e marrëdhënies e cila bazohet në bashkëpunim dhe komunikim.
- Ata duan marrëdhënie të afërta me profesionistët për zhvillim të hershëm fëmijëror.ⁱⁱⁱ

Këto gjetje i theksojnë pritjet e larta që prindërit kanë nga profesionistët; ata duan që praktikuesit të jenë të kujdesshëm dhe kompetent. Në të njëjtën kohë, prindërit theksojnë se duan të përfshihen dhe të kërkojnë një marrëdhënie dhe partneritet me profesionistë. Informimi, shpjegimi dhe arsye-timi i projektit edukativ të parashkollorit është thelbësor për familjet.

Të shikosh nga brenda se si një praktikë e qëllimshme është një ushtrim i vlefshëm në grup

. Nëpërmjet diskutimeve ekipore ne mund të ndërjegjësohemi për përvojat, shpresat, frikën dhe shqetësimet tona dhe të tjerëve.

Aktivitet reflektues në grup

Mendoni për fëmijërinë tuaj dhe përvojat tuaja në jetë. Në çfarë mënyre këto përvoja të kaluara, qofshin pozitive apo negative, do të mund t'i formojnë bindjet e juaja, si profesionist, për përfshirjen e prindërve dhe familjeve?

Çfarë frike, hezitimi keni për punën me prindërit apo përfshirjen e prindërve?

Në praktikën tuaj të deritanishme, cilat nga bindjet tuaja për prindërit kanë rezultuar të jenë të pasakta?

Me çfarë pasione, besime dhe anë të forta që do t'ju ndihmojnë të përfshini prindërit, dispononi?

Rekomandim: Dr. Karen Map mbi riformulimin e pikëpamjes sonë për familjet tona

<https://www.youtube.com/watch?v=KqHMNT2UtW0>

2.2. Nga t'ia filloni

“Shumë shpesh e nënvlerësojmë fuqinë e një prekjeje, një buzëqeshjeje, një fjale të mirë, një veshi që dëgjon, një komplimenti të sinqertë ose aktin më të vogël të kujdesit, ndërsa të gjithë ata kanë potencialin për të ndryshuar jetën. Është mahnitëse të shqyrtojmë mundësitë e vazhdueshme që ekzistojnë për të bërë dashurinë tonë të ndjehet”.

-Leo Buskalija

Pavarësisht nëse jeni duke organizuar një mbledhje prindërore ose punëtori për prindërit, ndërhyrja më themelore dhe më kritike për fëmijët dhe familjet është **të zhvilloni besimin**.

Margolis dhe Branigan^{iv} e vërejtën këtë përkufizim kur ata shkruan këtë: Për të ndërtuar besim, ju nevojitet të:

- (a) kultivoni një mentalitet bashkëpunues në vend të një mentaliteti konkurrues ose mbizotërues;
- (b) bëjeni përfshirjen tuaj me prindërit të kuptueshëm dhe me shqetësim;
- (b) bëhuni të hapur për objektivat tuaja;
- (r) demonstroi ekspertizë në mënyrë delikate pa qenë shtypës ose duke sinjalizuar epërsi.

Ndërtimi i besimit nuk mund të nxitohet. Është një proces ndërveprues që përfshin ndarjen e informacionit, ideve dhe ndjenjave. Fjala operative në ndërtimi-besim është reciprociteti. Është e rëndësishme të ndani në vend se të fshihni ndjenjat tuaja. Mendimet, megjithatë, duhet të shprehen në mënyra që prindërit mund t'i kuptojnë dhe vlerësojnë.

Mendoni për të gjitha nivelet e përfshirjes së prindërve në parashkollor: (Informimi, këshillimi, vendimmarrja e përbashkët, veprimi i përbashkët). Shikoni situatën në institucionin tuaj që nga kontakti i parë i prindërve me institucionin - vendndodhja, informata dhe shërbimi i regjistrimit, derisa fëmija të tërhiqet nga kopshti.

Hapi i parë për përfshirjen e prindërve në punë dhe vendimmarrje është inkurajimi i tyre për të regjistruar fëmijën e tyre në kopsht. Një numër i konsiderueshëm prindërisht nuk e dinë se cilat janë funksionet dhe cila është rëndësia e institucioneve parashkollore përveç kujdestarisë së fëmijëve.

Bëhuni transparent dhe ofroni prindërve të gjitha informacionet përkatëse për kopshtin e fëmijëve duke shfaqur afishe, **duke vendosur informacione në faqen tuaj të internetit, në mediat sociale, duke ftuar organizata partnere nga komuniteti lokal që t'i regjistrojnë prindërit në shërbimin tuaj.**

- *Së bashku me prindërit e fëmijëve të regjistruar, zhvilloni një doracak prindërisht për prindërit e rinj i cili do të përfshijë të gjithë informacionet e nevojshme, procedurat, rregullat, formularët, standardet e kurrikulës por edhe porosi mbështetëse për prindërit e rinj. Organizoni një ngjarje të nisjes dhe përfshini prindërit në organizimin dhe si vullnetarë në ngjarje. Publikoni doracakun në faqen e internetit të kopshteve dhe rrjetet sociale.*
- *Emëroni një person/a kontaktues parashkollor, për të ndihmuar dhe mbështetur prindërit në ndërveprimet e tyre me kopshtin parashkollor, publikoni një fotografi dhe kontaktin e atij personi në faqen e internetit të institucionit. Mendoni nëse ai person mund të xhirojë disa video të shkurtra për t'iu përgjigjur pyetjeve më të zakonshme që prindërit kanë në lidhje me procedurën e regjistrimit në kopshtin e fëmijëve. Siguroni një përkthim të videos në gjuhët e pakicave kombëtare dhe postojeni në ueb faqe dhe në rrjetet sociale.*

Mbani në mend se përfshirja e prindërve nuk është kurrë një ngjarje e vetme, por një proces! Në këtë fazë, prindërit kanë nevojë për ndihmë për të kuptuar se çfarë ofrohet në kopsht dhe pse ky shërbim është i mirë për fëmijën dhe familjen e tyre.

Natyra dhe niveli i mbështetjes të cilën e ofrojnë profesionistët në këtë proces ndryshojnë në varësi të hapave të ndryshëm dhe mënyrës në të cilën prindërit përgjithësisht u qasen shërbimeve të ndryshme. Disa prindër janë shumë të pavarur dhe informacioni bazë, për shembull, në një faqe interneti mund të jetë i mjaftueshëm për ta. Familjet e tjera, veçanërisht familjet në rrezik, kanë nevojë për më shumë inkurajim për t'u përfshirë, që mund të nënkuptojë që profesionistët duhet të flasim me familjen në disa raste.

Këshillë e mirë është të vlerësoni nivelin e sofistikimit të prindërve në lidhje me secilën temë në agjendë, në mënyrë që të mos i patronizoni ose t'i mbingarkoni ata me informacionin që ata nuk mund ta kuptojnë.^v (Tompson, R. 2006)

Pasi një fëmijë dhe familjet e tyre hyjnë në kopshtin e fëmijëve, profesionistët duhet të vazhdojnë të zhvillojnë marrëdhëniet me prindërit, gjë që mund të çojë në zhvillimin e bashkëpunimit me ta.

Nëse do të kishte një "formulë" të thjeshtë për përfshirjen e prindërve në punën e kopshtit, kush-timisht do të dukej kështu:

1. **Hartëzimi:** identifikoni atë që tashmë jeni duke bërë.
2. **Planifikimi:** identifikoni ndikimin e dëshiruar të strategjive të angazhimit familjar dhe si mund të matet kjo.
3. **Zbatimi:** bëni aktivitete të planifikuara dhe grumbulloni informata mbi treguesit e rezultateve.
4. **Vlerësimi:** vlerësoni informacionin e grumbulluar, nxirrni përfundime rreth rezultateve.

5. **Rishikimi:** komunikoni ndikimin, përdorni gjetjet për përmirësimin ose ndryshimin e strategjive ose veprimeve të planifikuara.

Për të krijuar kushtet që mundësojnë përfshirjen efektive dhe të qëndrueshme të prindërve duhet të jenë aktive disa struktura mbështetëse si në nivel të institucionit parashkollor ashtu edhe në nivel të një grupi individual.

Për shembull, ne sugjerojmë:

- **Organizoni ekipe për veprim për planifikim, zbatim dhe vlerësim të përfshirjes së prindërve.** Kjo mund të përfshijë formimin e ekipeve të reja ose shfrytëzimin e grupeve ekzistuese të punës;
- Koordinoni politikat dhe procedurat e brendshme të kopshtit për fëmijë në të cilat janë shprehur dhe integruar qartë praktikatat dhe parimet e përfshirjes së prindërve;
- Zbatoni dhe vlerësoni parimet dhe praktikatat e përfshirjes së prindërve në sektorë të ndryshëm në kopshtin për fëmijë dhe në nivel të grupit arsimor.
- Ndërtoni rrjete për mbështetje në komunitetin lokal dhe më gjerë, për shkëmbim të ideve, pyetjeve dhe praktikave më të mira;

2.2.1. Zhvillimi i besimit midis profesionistëve në ekip

Nxitja e besimit brenda komunitetit tuaj profesional është vendimtar dhe shpesh një hap i parë për rritje dhe bashkëpunim kuptimplotë me prindërit dhe familjet. Besimi që profesionistët ndërtojnë brenda një ekipi mund të shërbejë si një bazë e fortë për arritjen e qëllimeve të përfshirjes aktive të prindërve në punën dhe vendimmarrjen brenda institucionit parashkollor. Për të filluar ndryshime pozitive, është thelbësore të njihni dhe të shfrytëzoni potencialet dhe burimet brenda institucionit tuaj. Kjo shërben si një bazë e fortë për fillimin e punës dhe planifikimin e përpjekjeve bashkëpunuese me prindërit.

Hulumtoni katër atributet kryesore të besimit në marrëdhënie dhe reflektoni mbi përvojat tuaja brenda institucionit tuaj parashkollor.

1. Respektimi i dallimeve

Besimi ndërtohet mbi respektin i cili lind nga ndërveprimet sociale. Ai përfshin interes të vërtetë dhe dëgjim aktiv të këndvështrimeve të ndryshme, madje edhe kur përballemi me mosmarrëveshje. Kur individët ndihen të respektuar, madje edhe në konflikt, kjo nxit një mjedis ku njerëzit vlerësojnë njëri-tjetrin. Pa respekt ndër personal, ekziston rreziku i shmangies ose konflikteve të jashtme jo të shëndetshme.

- Si e njeh organizata juaj parashkollore dinjitetin individual dhe idetë e ndryshme në praktikë?
- A besoni se kolegët tuaj e dëgjojnë njëri-tjetrin në mënyrë aktive? Si e vlerësoni këtë?
- Mendoni për konfliktet e kohëve të fundit mes kolegëve. Çfarë ndodhi dhe si u zgjidhën këto? Çfarë mësimesh u nxorën?
- A ka komunikim të sjellshëm mes kolegëve dhe si e shprehni mirësjelljen ndaj tyre?

2. Konsiderata Personale

Ne u besojmë atyre që shkojnë përtej përgjegjësive të tyre formale dhe roleve të punës, duke demonstruar vullnet të mirë dhe mungesë qëllimi për të shkaktuar dëm.

- A mund të kujtoni raste kur një koleg tejkaloi kërkesat e punës për ju?
- Kur i keni zgjeruar kufijtë e rolit tuaj për të mirën e ekipit ose organizatës suaj??
- A e ndjeni se kolegët tuaj kujdesen për mirëqenien tuaj profesionale dhe personale dhe a ua ktheni këtë kujdes?

3. Kompetenca

Në një komunitet kopshti, besimi është i lidhur ngushtë me aftësinë e secilit person për të përmbushur rolin e tij në mënyrë efektive. Arritja e qëllimeve të përbashkëta varet nga kompetenca e çdo anëtari të ekipit. Çdo perceptim i mungesës së aftësive, njohurive ose vullnetit për të përmbushur rolin e dikujt mund të gjërryjë besimin. Nëse lihen të pazgjidhura, neglizhenca ose paaftësia mund të minojnë më tej besimin.

- A shihen kolegët tuaj të gatshëm dhe të aftë për të kryer me efikasitet përgjegjësitë e tyre të punës??

- A ka ndonjë dyshim për kompetencën e kolegëve apo eprorëve të caktuar?

- Identifikoni kolegët për të cilët keni rezerva lidhur me kompetencën e tyre. Sa për qind e fuqisë së përgjithshme punëtore përfaqëson kjo?

- A jeni i shqetësuar se kolegët tuaj mund të vënë në dyshim kompetencën tuaj dhe si mund ta adresoni këtë?

4. Integriteti personal

Integriteti është themeli i besimit; ai varet nga besimi se të tjerët do të respektojnë angazhimet e tyre dhe do të ruajnë integritetin personal dhe profesional. Ai gjithashtu përfshin respektimin e parimeve morale dhe etike, edhe kur interesat individuale bien ndesh brenda mjedisit shkollor. Mirëqenia e fëmijëve duhet të mbetet një shqetësim kryesor, edhe gjatë konflikteve të tilla.

Ndërtimi i besimit relacional është një proces i vazhdueshëm, por duke reflektuar mbi këto attribute, ju mund të kontribuoni për një mjedis profesional më të hapur dhe bashkëpunues. Përmes besimit mund të arrihet ndryshimi dhe përparimi i qëndrueshëm.

Ushtrim reflektues

Në çifte, përgjigjuni pyetjeve në vijim.

- Flisni për dikë që i besoni vërtet. Çfarë ju bën t'i besoni këtij personi? Si u zhvillua ky besim??
- Çfarë ndjenje është t'i besosh dikujt vërtetë?
- Si mësuat për besimin si fëmijë - p.sh. besimi në lidhjet me bashkëmoshatarët?
- A keni përvojë, si i rritur, kur besimi është prishur? Dhe kur veprimet tuaja kanë minuar besimin e dikujt tjetër tek ju? Si ju duken ato përvoja?
- Cilat janë bindjet tuaja personale për besimin? A është e vështirë të ndërtohet? E lehtë?
- A është më e vështirë të ndërtohet me njerëz që nuk kanë racën apo etninë tënde, prejardhjen tënde, gjininë tënde?
- Shkruani për dikë të cilit kohëve të fundit keni filluar t'i besoni - ndoshta një koleg, shef ose mik. Përshkruani se si u zhvillua ky besim - çfarë bëri ai person? Çfarë keni bërë ju?
- Çfarë mundëson që ky besim të rritet? Pse ai person dhe jo dikush tjetër? Çfarë mund të bëjë dikush që do të zvogëlonte besimin tuaj tek ai ose ajo?

2.3. Hartëzimi

Shënime për të mbajtur mend: Hartëzo, Planifiko, Bëj, Vlerëso, Rishiko

Hartëzoni **format ekzistuese të përfshirjes prindërore si dhe potencialin** që të qartësoni përpjekjet aktuale si një bazë për të përcaktuar se cilat janë hapat e parë në planifikimin e përfshirjes së prindërve.

Gjithashtu, hartëzimi mund t'ju ndihmojë të ndërlidhni burimet e përfshira në institucionin tuaj parashkollor me burimet në komunitet (duke përfshirë organizatat formale dhe joformale si shërbi- met shëndetësore dhe ato sociale, OJQ-të, klubet sportive, klubet e kulturës etj., si dhe bizneset, organet qeverisëse dhe institucionet).

Kushto vëmendje të posaçme ndaj:

- Sqarimit se cilat burime janë tashmë në dispozicion
- Si janë organizuar këto burime të bashkëveprojnë
- Cilat procedura ekzistojnë për përmirësimin e dobisë së burimeve

Ky lloj i vetë-studimit bëhet më së miri nga ana e ekipeve. Edukatorët fillimisht mund të punojnë veçmas në plotësimin e listës kontrolluese, por përfitimi i vërtetë vjen nga diskutimi i tij në grup.

Gjatë vitit, çdo edukator disa herë mund të bëjë hartëzimin e situatës në grupin e tij, në mënyrë të pavarur dhe në raport me prindërit e fëmijëve të regjistruar.

Lista kontrolluese mundëson organizimin e artikujve në një mënyrë sistematike dhe ju ofron **një përmbledhje të detyrave që duhet të përmbushni ose të merrni parasysh** në vend që të mbështeteni në kujtesën tuaj.

LISTA KONTROLLUESE E HARTËZIMIT TË PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE	
Detyra	Gjendja
Analiza e kornizës ekzistuese ligjore dhe akteve nënligjore (rekomandime, doracakë ...)	
Analiza e akteve të brendshme të institucionit (statuti, vendimet, planet)	
Krijoni një pasqyrë të qartë për komunitetin tuaj (struktura dhe nevojat e popullsisë dhe si zbatohet kjo në institucionin parashkollor?)	
Krijoni një pasqyrë të qartë për gjendjen familjare të fëmijëve të regjistruar. Duke i marrë parasysh të gjitha format e diversitetit, siç janë përkufizimi socio-ekonomik, etnik dhe kulturor, gjuhësor, aftësia e kufizuar dhe familja (p.sh. familjet kujdestare, familjet prindërore adoleshente).	
Radhitni aktivitete specifike që inkurajojnë përfshirjen e prindërve në institucionin tuaj.	
Radhitni procese dhe praktika ekzistuese të përfshirjes së prindërve.	
Analizoni mënyra për mbikëqyrjen e aktiviteteve për përfshirje të planifikuara të prindërve. Nënvizoni treguesit të cilat i mbikëqyrni.	
Radhitni mënyra për vlerësimin e proceseve dhe aktiviteteve për përfshirje të prindërve.	
Analizoni se si zhvillimi profesional i të punësuarve mbështet proceset e përfshirjes së prindërve (saktësoni trajnime, seminare specifike)	
Analizoni shkallën e lidhjes suaj me institucionet parashkollore nga qytetet, shtetet tjera me asociacionet profesionale	
Analizoni nevojat e të punësuarve për edukim plotësues (p.sh. puna me prindër "të vështirë", mbështetje të fëmijëve dhe familjeve në rrezik...)	
Vini re se si dhe kur përfshirja e prindërve është një temë e njohur në takimet e ekipit.	
Analizoni se si koncepti dhe praktika e përfshirjes së prindërve futet tek personeli i ri	
Analizoni se si institucionet parashkollore i njohin dhe mbështesin prindërit vullnetarë	
Radhitni veprimet me të cilat institucionet parashkollore i festojnë ngjarjet me rëndësi për komunitetin, siç janë ditët me rëndësi kulturore?	
Analizoni kanalet e duhura dhe efektive të komunikimit që përdorni për të kontaktuar prindërit	
Analizoni pengesat për përfshirje të prindërve	
Radhitni mënyrat paraprake për tejkalimin e pengesave për përfshirje të prindërve	
Identifikoni dikë nga anëtarët e stafit i cili më herët ka qenë i suksesshëm në angazhimin e familjeve të ndryshme, në institucionin parashkollor ose diku tjetër. Radhitni parimet dhe procedurat më specifike që shpijnë në sukses në bashkëpunim me prindërit.	
Identifikoni persona me ndikim në komunitet që mund të ndihmojnë në promovimin e aktiviteteve për angazhim të familjes?	
Gjeni një anëtar të stafit i cili do të mund të sjell perspektivat e edukatorëve dhe stafit tjetër në institucionin parashkollor tek personi me ndikim në komunitet.	
Identifikoni prindër ose anëtarë të familjes që mund të sjellin perspektivat e tyre (p.sh. Edukimi special, Programe të mësimin të gjuhës angleze).	
Identifikoni 'udhëheqësit prindër' të mundshëm që janë përfaqësues të familjeve të ndryshme në institucionin tuaj parashkollor.	
Hartëzoni institucionet, organizatat në komunitetin lokal që mbështesin fëmijë dhe familje.	
Analizoni bashkëpunimin e tanishëm me institucionet dhe organizatat në komunitetin lokal. Krijoni tregues për sukses të bashkëpunimit.	
Analizoni mënyra në të cilat edukatorët për mbështetje parashkollore dhe prindërit duhet të përdorin forma të ndryshme të mediave (përfshi mediat onlajn dhe ato sociale) në mënyrë të duhur dhe efektive?	

2.3.1 Identifikoni pengesat në përfshirjen e prindërve

Një pjesë e rëndësishme e hartëzimit është diskutimi dhe identifikimi i pengesave që mund të pengojnë përfshirjen e prindërve në punën e institucionit parashkollor.

Merrni parasysh disa nga pengesat në praktikën e përfshirjes së prindërve - a keni vënë re shpesh komente të bëra në lidhje me këtë temë? A keni dëgjuar ndonjëherë veten ose kolegët e tjerë të bëjnë komente të ngjashme? Si mund t'u kundërpërgjigjeni disave nga këto?

PENGESAT NË PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE	
Të menduarit e padobishëm	Çfarë të bëni?
Prindërit nuk u bëhet vonë/nuk janë të interesuar	<p>Disa prindër janë të interesuar për fëmijën e tyre, por mund të mos jenë të interesuar të ndërveprojnë me institucionin parashkollor. Ekziston një ndryshim midis këtyre të dyjave.</p> <p>Në disa familje, angazhimi i një prindi në jetën e një fëmije ka më shumë gjasa të ndodhë në shtëpi përmes lojës dhe bisedës, gjatë kohës kur familjet janë së bashku. Profesionistët mund të mos 'e shohin' këtë.</p> <p>Disa prindër mund të mos jenë të vetëdijshëm për llojet e ndryshme të përfshirjes që ekzistojnë. Prindërit mund të kenë frikë të ndryshme nga kritikën e profesionistëve, ose mund të mos jenë të sigurt se çfarë pritshmëri kanë profesionistët prej tyre.</p> <p>Merrni parasysh qasje të ndryshme për informimin dhe përfshirjen e prindërve dhe familjeve të ndryshme. Investoni kohë për të biseduar me prindërit për këto tema.</p>
Prindërit nuk shfaqen, ose çdo herë shfaqen personat e njëjtë	<p>Merrni parasysh me kujdes kohën, datat dhe disponueshmërinë e informacionit për aktivitetet e ndryshme që organizoni.</p> <p>Kur prindërit që marrin pjesë rregullisht janë të disponueshëm, pyesni pse prindërit e tjerë mund të mos marrin pjesë. Sigurohuni që t'u afroheni prindërve me ndjeshmëri kur kërkon kontributin e tyre (së pari, investoni kohë në ndërtimin e një marrëdhënieje).</p>
Prindërit na kontaktojnë vetëm kur ka ndonjë problem	<p>Shumë prindër mund të ndihen njësoj kur profesionistët e institucionit parashkollor i kontaktojnë ata!</p> <p>Kjo mund të tregojë se ata nuk janë mjaftueshëm të njohur me qëllimin e përfshirjes në aktivitetet e kopshteve. Përfshirja e prindërve kërkon gjithmonë ndërveprime sistematike, të planifikuara, të rregullta, të vazhdueshme dhe të qëllimshme ndërmjet prindërve dhe profesionistëve.</p>
Disa prindër thjesht nuk duan të angazhohen. Kjo nuk është në kulturën e tyre	<p>Është një stereotip i zakonshëm që familjet që përballen me rrezik social nuk e vlerësojnë arsimin ose nuk janë të interesuara për zhvillimin e fëmijëve të tyre. Këto paragjykimet profesionale përjetësojnë status quo-në në mbështetjen e familjeve në rrezik. Investoni kohë në zhvillimin e kompetencës kulturore dhe ndjeshmërisë ndaj diversitetit social.</p>

	Përpiquni të theksoni rëndësinë e përfshirjes dhe barazisë duke diskutuar me prindërit mundësitë për të gjithë fëmijët.
Është shumë punë për profesionistët/nuk kemi kohë.	Ndryshimet në praktikën e punës janë pjesë përbërëse e punës sonë. Futja e inovacionit në praktikën tuaj nuk do të thotë domosdoshmërisht se do të punoni më shumë, por mund të kërkojë të punoni ndryshe. Ndani kohë për të reflektuar se përse përfshirja e prindërve është e rëndësishme, jo vetëm për fëmijën dhe prindin, por edhe për ju si profesionist.
Nuk dimë nga t'ia fillojmë	Filloni duke ndërtuar mbi atë që tashmë jeni duke bërë dhe bëni ndryshime gradualisht.
Jemi duke e bërë këtë.	Kjo është e saktë. Disa aspekte të konceptit të përfshirjes së prindërve mbështeten në praktikën tuaj aktuale. Me njohuritë e reja dhe zbatimin e doracakut, ju do t'i vlerësoni dhe përmirësoni praktikën tuaj.
Nuk kemi mbështetje.	Ndani kohë për të reflektuar mbi llojet e mbështetjes në dispozicion të institucionit tuaj, si me kolegët tuaj ashtu edhe në mënyrë të pavarur. <ul style="list-style-type: none"> • Cilat nga format e disponueshme të mbështetjes i përdorni aktualisht? • Çfarë mbështetje shtesë mund të jetë e dobishme për ju? • Çfarë lloj mbështetjeje do të ishte e dobishme në këtë situatë?

2.4. Planifikimi

Rekomandim: Jenni Brasington, Sa efektive janë nismat, strategjitë dhe praktikën tuaj për angazhimin e familjes?

<https://www.youtube.com/watch?v=HP0ADQLu1zA>

Deri tani, keni kuptuar se përfshirja e prindërve shtrihet shumë përtej pjesëmarrjes së thjeshtë në mbledhjet e prindërve. Është një kuptim të cilin si profesionistët ashtu edhe prindërit, së bashku me palët e tjera të interesuara, duhet t'i përfitojnë në mënyrë aktive njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ushqyer dhe mbajtur marrëdhënie dhe angazhime kuptimplotë.

Është thelbësore të kihet parasysh se profesionistët kanë një rol jetik në ofrimin e mundësisë për të ndërtuar kapacitetin për partneritete efektive, palëve të ndryshme. Kjo nuk është vetëm një përgjegjësi; është një angazhim për nxitje të marrëdhënieve pozitive me prindërit. Vështrime të mëtejshme mbi këtë temë mund të gjenden në Kapitullin 4.

Angazhimi i prindërve dhe familjes, siç e përkufizojmë ne, është "një partneritet i qëllimshëm dhe sistematik midis edukatorëve, familjeve dhe anëtarëve të komunitetit. Ky partneritet ndan përgjegjësinë për përgatitjen e një fëmije për shkollën, punën dhe jetën, nga foshnjëria deri në moshën madhore të re."

Këtu, ne vendosim theksin te përkufizimet 'qëllimshëm' dhe 'sistemor' për të nënvizuar rëndësinë e profesionistëve, familjeve dhe palëve të tjera të interesuara që punojnë në mënyrë bashkëpunuese. Kopshtet për fëmijë duhet ta integrojnë në mënyrë pro-aktive këtë angazhim në qëllimet e tyre profesionale për të mësuarit dhe zhvillimin e fëmijëve.

Një komponentë themelore e kësaj qasjeje është përkushtimi i fortë ndaj një perspektive holistike (gjithëpërfshirëse) për përfshirjen e prindërve. **Ky angazhim fillon me bisedat mes të gjithë stafit të institucionit parashkollor - atyre që ndërveprojnë drejtpërdrejt me prindërit dhe atyre që nuk ndërveprojnë - për vlerën dhe kuptimin e përfshirjes së prindërve në kontekstin e punës dhe vendimmarrjes së kopshtit.**

Themeli për krijimin dhe edukimin e një kulture të përfshirjes së bazuar në marrëdhënie qëndron në udhëheqjen efektive. Në praktikë, kjo do të thotë të mbështesim me gjithë zemër drejtorin e kopshtit dhe anëtarët e këshillit drejtues.

Përfshirja e prindërve në kopshte funksionon në disa nivele, dhe planifikimi e zbatimi duhet të përshtaten ndaj këtyre niveleve të ndryshme të punës, nga niveli institucional në atë grupor.

Përpara planifikimit dhe zbatimit, është thelbësore të identifikohet ekipi kryesor i planifikimit dhe të caktohet një koordinator. Angazhoni profesionistë të ndryshëm që punojnë brenda kopshtit. Një pikënisje e mirë është të kryeni një analizë të situatës për vendin tuaj, duke vlerësuar ndikimin e politikave dhe ndërhyrjeve aktuale brenda kornizës së ligjeve kombëtare.

Krijimi i një ekipi bazik për planifikim është thelbësor për udhëheqjen dhe ekzekutimin e procesit të planifikimit për krijimin dhe nxitjen e një kulture të përfshirjes së prindërve të bazuar në marrëdhënie në institucionin tuaj parashkollor.

Ekipi duhet të përfshijë përfaqësues nga të gjitha palët kryesore të interesit në institucionin tuaj parashkollor, siç janë edukatorët, bashkëpunëtorët profesional dhe profesionistët që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt me fëmijët dhe prindërit. Po ashtu është me vlerë përfshirja e anëtarëve të tjerë, si përfaqësuesi i prindërve, anëtarët e institucioneve të komunitetit lokal dhe anëtarët e këshillit drejtues.

Sektorë të ndryshëm brenda kopshtit mund tashmë të kenë për vlerësim dhe elementet e përfshirjes së prindërve mund të jenë tashmë të integruar në to.

Për më tepër, merrni parasysh aspektin transformues të kultivimit të një kulture të përfshirjes së prindërve. Hulumtimet vazhdimisht tregojnë se angazhimi i prindërve jo vetëm që i bën rolet e profesionistëve më të menaxhueshëm, por edhe më përmbushës.

Ka shumë mënyra krijuese për t'u qasur këtij transformimi. Për shembull, ju mund të organizoni takime ose seminare me të gjithë profesionistët për të diskutuar të kuptuarit e tyre për përfshirjen e prindërve dhe perceptimin e tyre për mjedisin aktual. Krijoni një mjedis që mundëson kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për hulumtimin e aspekteve të ndryshme të ngritura në këto diskutime. Ky proces paraqet një mundësi të shkëlqyer për të hartuar një deklaratë vizioni në bashkëpunim me të gjithë stafin, siç sqarohet më vonë në këtë seksion.

Një element kyç i këtyre diskutimeve është reflektimi mbi pengesat e mundshme për një angazhim të suksesshëm me familjet. Kushtojini kohë diskutimit të shqetësimeve ose pengesave për angazhim me familjet dhe trajtoni në mënyrë aktive këto shqetësime.

Sigurohuni që qëllimi i përfshirjes së prindërve të jetë i qartë. Përveç dhënies së informacionit themelor për rëndësinë e përfshirjes së prindërve në punën e kopshtit, përcaktoni objektivat tuaja, shpjegoni arsyet prapa ndryshimit dhe artikulonit praktikën e dëshiruara që synoni t'i zbatoni. Kjo qartësi është e domosdoshme, pasi një qëllim i përcaktuar mirë shpie në forcimin e komunitetit të kopshtit dhe nxit përkushtimin e të gjithë anëtarëve të ekipit.

Gradualisht, përfshini të gjitha palët e interesuara dhe kryeni orientime për t'u siguruar që të gjithë të përputhen me të kuptuarit e tyre të objektivave në çdo fazë të procesit.

Për udhëzime më specifike mbi komunikimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve me kolegët, mund t'i referoheni kapitullit të katërt të këtij doracak.

Pyetje udhëzuese për të prodhuar disa bashkëbisedime midis ekipit:

Cila është përvoja juaj me përfshirjen e prindërve në punën dhe vendimmarrjen e një kopshti për fëmijë?

Çfarë funksionon mirë?

Çfarë nuk funksionon dhe aq mirë?

Çfarë është më e kënaqshme për zhvillimin e marrëdhënieve të forta me prindërit?

Çfarë është më pak e kënaqshme?

Cilat aspekte të punës suaj mund të përfitojnë nga përfshirja e prindërve? Pse?

Cilat aspekte të punës suaj mund ta bëjnë të vështirë zbatimin e përfshirjes së prindërve? Pse?

Shënime për ekipin!

- Mendoni dhe pajtohuni për veprimet
- Përcaktoni përgjegjësitë
- Mbikëqyrni përparimin
- Vlerësoni
- Mbajeni derën të hapur për aktorë të rinj, ide të freskëta.
- Bëhuni elastik
- Festoni suksesin!

Nëse jeni në rrugën e ndërtimit të marrëdhënieve me prindërit vetë, pa mbështetjen sistematike të kopshtit, mos u shqetësoni. Informatat dhe njohuritë nga ky doracak mund të jenë një mbështetje dhe një frymë pas shpine në rrugën tuaj për përfshirje të prindërve në punën e grupit tuaj.

Ajo që përfundimisht e rekomandojmë si një burim të shkëlqyer për praktikuesit është libri i **Jesper Jul** dhe **Hele Jensen** "Nga bindja në përgjegjësi - drejt një kulture të re arsimimi".

2.4.1. Përgatitja e një Propozim deklarate të vizionit

Diskutimi i deklaratës së vizionit për përfshirjen e familjes në institucionin tuaj parashkollor është një hap kyç për sigurimin e një drejtim të qartë dhe efektiv. Deklarata juaj e vizionit do të shërbejë si një dritë udhëzuese gjatë gjithë procesit të angazhimit të prindërve në jetën e kopshtit. Është një busull që ofron një pamje gjithëpërfshirëse të asaj që ju aspironi të jetë praktika e përfshirjes së prindërve brenda kopshtit tuaj.

Për shembull:

- Kontributi i çdo prindi është i paçmuar.
- Çdo prind ka potencialin për të përmirësuar cilësinë e kopshtit tonë.
- Çdo prind është lehtësisht i arritshëm.

Ky ushtrim synon të kristalozojë mendimet tuaja aktuale, me versionin përfundimtar që zhvillohet në bashkëpunim me të gjithë palët e interesuara në fazat e mëvonshme të procesit.

Merrni parasysh veçoritë unike të mjedisit dhe kontekstit të institucionit tuaj parashkollor. Parashtroni pyetje siç janë:

- Si do të duket institucioni ynë parashkollor nëse do të ketë përfshirje të madhe të prindërve?
- Çfarë lloj praktikash të përfshirjes së prindërve parashikojmë?
- Çfarë duhet të kemi prioritet si hapa fillestare?
- Çfarë ndryshimesh janë të nevojshme për të jetësuar këtë vizion?

Kur përfshini palë të tjera të interesuara, përfshirë prindërit dhe organizatat e komunitetit lokal, mendoni për këto në vijim:

- Çfarë njohurish apo aftësish do të përvetësojnë ata?
- Si do të lidhen ata emocionalisht me këtë vizion??
- Çfarë veprimesh do të ndërmarrin për ta mbështetur atë?

Pasi të hartohet deklarata juaj e vizionit, vlerësoni se si mund të pranohet ajo:

- A do të ketë jehonë me të gjithë prindërit?
- Nëse jo, cilët prindër mund të mos lidhen me të dhe pse?

Një deklaratë vizioni e hartuar mirë ka fuqinë të bashkojë, frymëzojë dhe nxis ndryshime pozitive në praktikat e përfshirjes familjare të institucionit tuaj parashkollor. Është gur themeli mbi të cilin mund të ndërtohen përpjekjet bashkëpunuese.

Rekomandim: Dr. Heather B. Weiss Parashikimi dhe ndërtimi i angazhimit të familjes dhe të komunitetit 2.0

https://www.youtube.com/watch?v=TI_xrDHWI2E

2.4.2. Lista kontrolluese për planifikimin e përfshirjes së prindërve në punën dhe vendimmarrjen në kopsht


Lista kontrolluese e ofruar përfshin tema SHITESË të rëndësishme (dhe sqarime të shtuara) të cilave duhet t'u kushtoni vëmendje gjatë procesit të planifikimit.

Planifikimi i përfshirjes së prindërve në punën dhe vendimmarrjen në kopsht		
DETYRA	SQARIMI	GJENDJA
Planifikoni së bashku, zbatoni sipas sektorëve	Mbani në mend se kontakti i parë i një prindi me kopshtin për fëmijë, zakonisht është kur ai e regjistron fëmijën në kopsht. Atëherë, nëse jo edhe më parë, duhet të fillojë bashkëpunimi juaj dhe përfshirja e prindërve. Lehtësojeni këtë duke siguruar që secili sektor të jetë plotësisht i angazhuar në planifikimin e përfshirjes së prindërve dhe se secili do të zbatojë aktivitetet për të cilat është përgjegjës. Pritjet duhet t'i keni të qarta lidhur me atë se çfarë pritet dhe çfarë nuk pritet nga anëtarë të ndryshëm të stafit në lidhje me përfshirjen e prindërve dhe sigurohuni që të ketë sasi përkatëse të kohës në dispozicion.	
Vendosni qëllime reale dhe të matshme dhe ndërhyrje që janë të dobishme për fëmijën, prindërit dhe familjet.	Është mirë të ndërtohet mbi atë që tashmë ekziston. Zgjidhni një numër të kufizuar qëllimesh për aktivitetet. Zgjidhni ato në mënyrë që të jenë elastike dhe të dobishme për fëmijët, prindërit, familjet dhe kopshtin dhe sigurohuni që burimet e nevojshme të jenë në përputhje me burimet që zotëroni..	
Punoni në qarqe	Pa marrë parasysh a jeni duke zhvilluar një plan afatshkurtër ose një plan strategjik afatgjatë, ju do të vlerësoni situatën aktuale, do të përcaktoni ndërhyrjet, do të rishikoni përparimin dhe do të kërkoni mënyra për të forcuar ose ndryshuar ndërhyrjet ekzistuese. Mbani në mend se planifikimi nuk është një akt njëherësh, por ky cikël do të përsëritet gjatë vitit të punës në përputhje me kontekstin specifik të institucionit dhe grupit.	
Pyesni prindërit!	Zhvilloni një qasje sistematike për të siguruar që pikëpamjet e prindërve dëgjohen dhe reagohej ndaj tyre, dhe që	

	kopshti rregullisht u jep përgjigje prindërve dhe kërkon komente të mëtejshme për veprimet e ndërmarra.	
Ndani nivelet e përfshirjes së prindërve	<ul style="list-style-type: none"> • Informimi • Këshillimi • Vendimmarrja e përbashkët • Puna e përbashkët <p>Këto nivel shpesh ndërthuren, por është mirë t'i keni parasysh gjatë planifikimit.</p>	
Zhvilloni qasjen për përfshirje të palëve të reja të interesuara	Diskutoni se si do t'i përfshini prindërit e ri, fëmijët e të cilëve regjistrohen në grup gjatë vitit të punës ose edukatorët e rinj në procesin e përfshirjes së prindërve në punën e kopshtit, etj..	
Krijoni një afat kohor për përmbushjen e secilës strategji dhe plan për mbikëqyrje të përparimit dhe për të bërë rishikime.	Kërkoni mundësi për mbikëqyrje dhe vlerësim në sektorë të ndryshëm.	
Festoni suksesin!		

2.5. Vlerësimi

Vlerësimi mund të kryhet gjatë gjithë vitit në formën e kontrolleve periodike të përparimit dhe në fund të vitit si vlerësim vjetor. **Rekomandimi ynë është që të kryhen të dyja, që do të thotë të mbikëqyret fillimi, përparimi dhe kulmimi i një aktiviteti përmes një vlerësimi të vazhdueshëm të rezultateve të tij.** Informacioni dhe njohuritë e nxjerra nga reflektimi i ekipit duhet të këmbehen me familjet dhe komunitetin e gjerë të shkollës për të grumbulluar komentet e tyre dhe për të forcuar më tej besimin midis profesionistëve dhe prindërve.



Mund të përdorni **vlerësimin e procesit** për të marrë informata kthyesë që mund të përdoren menjëherë për të rregulluar ose përmirësuar aktivitetet gjatë vitit.

Disa nga pyetjet mbi vlerësimin e procesit mund të përfshijnë:

1. A e bëjmë atë për të cilën u pajtuam?
2. Nëse aktivitetet e planifikuara nuk zbatohen, pse jo? A ka probleme me shtrirjen, logjistikën apo faktorë të tjerë?
3. Me se jeni të kënaqur në kuadër të aktivitetit të planifikuar deri më tani?
4. Me se nuk jeni të kënaqur në kuadër të aktivitetit të planifikuar deri më tani?
5. A jeni duke e marrë atë që prisni?
6. Çfarë mund të ndryshoni në këtë çast?
7. Si mund të vazhdoni?
8. Çfarë ju ka befasuar?
9. Çfarë nuk keni pritur?
10. Çfarë ju ka ndihmuar?
11. Çfarë ju ka shqetësuar?
12. Çfarë do të bëni përsëri?

Disa nga pyetjet për vlerësimin e rezultateve mund të përfshijnë:

1. Çfarë ka ndryshuar në punën tuaj të përditshme me fëmijët për shkak të aktiviteteve që përfshijnë prindër?

2. Çfarë ka ndryshuar në marrëdhëniet tuaja të menjëhershme me prindërit për shkak të aktiviteteve që përfshijnë prindër?
3. Çfarë ka ndryshuar në marrëdhëniet tuaja me kolegët për shkak të aktiviteteve që përfshijnë prindër?
4. Nëse keni vënë re ndonjë ndryshim tjetër në punën tuaj, qoftë pozitive apo negative, ju lutemi radhitni ato sa më konkretisht të jetë e mundur.
5. Nëse aktivitetet nuk kanë dhënë rezultatet e dëshiruara, çfarë pengesash janë hasur?
6. A i keni rritur njohuritë dhe aftësitë e juaja relevante në fushën e ndërtimit të marrëdhënieve me prindërit?
7. Cilat janë disa tregues se aktivitetet për përfshirje të prindërve mund të jenë në dobi të fëmijëve? Në cilët aspekte shihni zhvillim?
8. Me çfarë efikasiteti arrini deri te prindërit e synuar?

Po ashtu, mos e harroni vetëvlerësimin. Vetëvlerësimi është vendimtar për edukatorët parashkollor në vlerësimin e punës së tyre. Ai u ndihmon ata të identifikojnë anët e forta dhe fushat për përmirësim, duke rritur përfundimisht cilësinë e edukimit të hershëm fëmijëror. Në këtë kontekst, mjetet për vetëvlerësim mund të gjenden në burimet e përmendura në doracak, duke lehtësuar rritjen dhe zhvillimin profesional.

Planifiko, Bëj, Vlerëso, Rishiko

Mbani në mend ...

- Të dy llojet e vlerësimit mund të kryhen pas çdo takimi (ose aktiviteti me prindërit), në fund të gjysmë vjetorit ose në një kohë tjetër të caktuar.
- E dobishme është të kombinohet vlerësimi me shkrim, i cili u mundëson pjesëmarrësve të thellohen dhe të reflektojnë mbi përvojat e tyre (dhe të shmangin përgjigjet "edhe unë"), me vlerësimin gojor që u jep pjesëmarrësve mundësinë të reflektojnë mbi ndjenjat, pritjet, mendimet e tyre dhe të bëjnë plane për të ardhmen.
- Nëse realizohet një vlerësim me shkrim, grupi duhet të përcaktojë personin(at) përgjegjës për përpunimin e të dhënave. E rëndësishme është që ky person të jetë i gatshëm të marrë përsipër detyrën dhe jo domosdoshmërisht nuk duhet të jetë bashkëpunëtor profesional.
- Nëse të dhënat e grumbulluara përmes vlerësimit do të përdoren për të shkruar një punim profesional ose për një qëllim të ngjashëm, pëlqimi me shkrim nga prindërit është i nevojshëm.

2.5.1. Anketat

Anketat janë mjete të fuqishme që u japin profesionistëve mundësinë për të matur çdo gjë për të cilën mendoni se është e rëndësishme në baza të rregullta.

Anketat e pulsit janë një metodë për matjen e reagimeve duke përdorur kontrolle më të shkurtra dhe më të shpeshta, që nuk janë të lidhura me matjen e temave ose përmbajtjeve specifike. Anketa e pulsit është efektive sepse është e shkurtër dhe e lehtë për t'u përfunduar dhe u jep këndvështrime të ndryshme për tema siç janë bashkëpunimi, përfshirja e prindërve, komunikimi, funksionaliteti i kohës, nevojat etj. Ato mund të përdoren me të gjitha palët e interesuara në procesin e përfshirjes së prindërve në punën dhe vendimmarrjen në institucionin parashkollor.

Kjo do të thotë se përmbajtja që matet mund (dhe duhet) të ndryshojë nga kopshti në kopsht dhe madje nga një anketim në tjetrin.

Përfitimet e anketës së pulsit:

- Tregojnë interes për këndvështrimin e prindërve (pikëpamja dhe gjithashtu të kuptuarit e disa koncepteve profesionale si përfshirja e prindërve në vendimmarrje).
- Gjurmojnë të njëjtin artikull me kalimin e kohës, p.sh. “A do të preferonit të bëheni pjesë e një seminari apo një leksioni rreth ...?”
- Ato janë të shkurtra dhe të lehta për t'u plotësuar (mund të shpërndahen në internet nëpërmjet formularit të Google ose Viber, WhatsApp)
- Të dhënat përpunohen lehtë.
- Mund të përdoren më shpesh.

Mos harroni se jo të gjithë do të pranojnë t'i përgjigjen një ankete (për arsye të ndryshme). Të dhënat e grumbulluara i përfaqësojnë vetëm ata që janë përgjigjur, keni parasysh nëse ata të që janë motivuar për t'u përgjigjur mund të kenë këndvështrime të ndryshme nga ata që nuk kanë marrë pjesë.

Mund të mendojmë se përqendrimi ynë është tek ajo që na e tregon anketa, por është po aq e rëndësishme të marrim parasysh atë që nuk na e tregon anketa!

Mund të jetë e dobishme të organizohen grupe diskutimi për prindërit dhe familjet për të diskutuar gjetjet e anketës, në mënyrë që të mund të dëgjoni nga një gamë më e gjerë këndvështrimesh dhe të mund t'i përdorni rezultatet për të fituar edhe më shumë këndvështrime për një temë të caktuar.

Faktorët kryesorë që duhet të merren parasysh për t'u siguruar që të përfitoni sa më shumë nga anketa.	
GJATËSIA	Shumë pyetje çojnë në lodhje gjatë përgjigje, kështu që është e rëndësishme që anketa të jetë e shkurtër.
KOHA	Llogaritni me kujdes kohën e anketës, keni parasysh festat, fundin e javës... gjithashtu llogaritni se sa kohë do të jetë e hapur për përgjigje anketa.
VULLNETARE DHE E BESUESHME	Dërgoni porosi të qartë se pjesëmarrja është vullnetare dhe e besueshme; se nuk ka përgjigje të gabuara apo të sakta; dhe se zgjedhja për pjesëmarrje në anketë nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë tek fëmija i tyre.
QASSHMËRIA	Bëhuni elastik me opsionet e juaja të qasshmërisë dhe ofroni anketën tuaj në formate të ndryshme (onlajn, në letër, gojarisht). Merrni parasysh përkthimin e anketave në gjuhët përkatëse për familjet e ndryshme.

2.6. Organizimi i takimeve në grup për prindër

Kapitujt e mëposhtëm (deri në kapitullin 3) do t'ju japin informacionet përkatëse të nevojshme për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve në grup për prindërit.

Përpara se të hyjmë në detajet e organizimit të takimeve në grup me prindërit, është e rëndësishme të nënvizojmë rëndësinë e komunikimit me prindërit, i cili është bazë për marrëdhënie cilësore dhe përfshirje të prindërve në punën e kopshteve.

Në pjesën e katërt të doracakut, mund të lexoni më shumë rreth teknikave të komunikimit dhe përgjatë doracakut, komunikimi bindës është baza mbi të cilën rekomandojmë që profesionistët të ndërtojnë marrëdhënie me prindërit.

Komunikimi bindës është një stil komunikimi në të cilin individët mund të shprehin qartë mendimet, qëndrimet dhe ndjenjat e tyre, si dhe të mbrojnë të drejtat e tyre, pa cenuar nevojat dhe të drejtat e të tjerëve. Ndërsa ata i trajtojnë të tjerët me respekt, komunikuesit bindës i vlerësojnë nevojat e tyre dhe nuk heqin dorë prej tyre. Kjo formë e komunikimit mund të përfshijë sjellje dhe ndjenja të ndryshme:

- shprehje e mendimeve dhe ndjenjave të veta nëpërmjet "Fjalimit-Unë"
- dëgjim aktiv pa e ndërprerë bashkëbiseduesin
- ruajtje e kontaktit me sy
- ton i qetë gjatë bisedës
- ndjenjë e kompetencës dhe mbajtje nën kontroll të situatës
- avokim
- gjuhë e relaksuar e trupit dhe komunikim jo verbal
- ndjenjë kontrolli mbi sjelljen e dikujt
- ndjenjë e lidhjes me të tjerët

Të jesh bindës nuk do të thotë vetëm të mësosh aftësi të reja dhe të komunikosh më mirë: vetëbesimi është një aftësi kyçe për të kontrolluar emocionet dhe për të menaxhuar stresin. Zotërimi i kësaj aftësie mund t'ju ndihmojë të rrisni vetëvlerësimin, vetëbesimin dhe të ndërtoni marrëdhënie të bazuara mbi respektin reciprok. Prandaj, vendosmëria ka një potencial të lartë për rritjen e cilësisë së jetës suaj.

Konsideratat kryesore për nxitjen e komunikimit bindës në kopshtin e fëmijëve përfshijnë:

- Komunikimi është "rrugë me dy drejtime": mund të iniciohet dhe drejtohet si nga prindërit ashtu edhe nga profesionistët.
- Komunikimi ballë për ballë: profesionistët krijojnë mundësi që prindërit të angazhohen në komunikim të hapur, ballë për ballë (ose në internet).
- Komunikimi është i rregullt dhe i qëndrueshëm: kjo është e rëndësishme për ruajtjen e lidhjes dhe kontribuon në perceptimin e prindërve për ndjenjën e vlerësimit dhe ndjenjën se ata mund të ndikojnë në zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijës së tyre.
- Gjuha e përshtatshme: Profesionistët nuk supozojnë një nivel të caktuar njohurish të cilin prindërit mund të mos e kenë. Ata përshtatin gjuhën e tyre në kontekste të ndryshme kulturore, minimizojnë ose shpjegojnë terminologjinë profesionale.
- Profesionistët shfrytëzojnë kanale të shumëfishta për komunikim dhe informim.

2.6.1. Hulumtoni nevojat

1. Shfrytëzoni çdo mundësi për të vlerësuar nevojat e prindërve.

- Për të filluar procesin, është thelbësore të fitoni një kuptim të thellë të nevojave, shqetësimeve dhe preferencave të prindërve. Kjo mund të arrihet me mjete të ndryshme:
 - Krijoni pyetësorë dhe anketa miqësore për përdoruesit duke përdorur platforma si Viber, Facebook, email ose faqen e internetit të institucionit.
 - Sigurohuni që këta pyetësorë të jenë të përmbledhur dhe të lehtë për t'u plotësuar.
 - Grumbulloni dhe analizoni me zell informatat kthyesë për të identifikuar temat dhe shqetësimet e përbashkëta të shprehura nga prindërit.

2. Përshtatja e përmbajtjes për të adresuar shqetësimet

- Pasi të keni mbledhur njohuri nga prindërit, është koha ta përdorni atë informacion të vlefshëm për të përshtatur qasjen tuaj:
 - Planifikoni takimet dhe punëtoritë tuaja në grup **rreth çështjeve dhe pyetjeve të ngritura nga prindërit.**
 - Si profesionistë, ju mund të identifikoni sfidat për të cilat prindërit mund të mos jenë ende të vetëdijshëm. Adresimi i këtyre shqetësimeve do të tregojë përkushtimin tuaj për mirëqenien dhe suksesin e tyre.

3. Krijimi i temave angazhuese për takime

- Për të kapur interesin e prindërve, është thelbësore të ofrohen tema që janë të rëndësishme dhe angazhuese:
 - Identifikoni temat që lidhen drejtpërdrejt me sfidat dhe pyetjet e shprehura nga prindërit.
 - Ndani përmbajtje informative përmes kanaleve të shumta të komunikimit si tabelat e buletinit, buletinet dhe platformat e mediave sociale.

4. Bëni kujdes me titujt

- Përzgjedhja e fjalëve mund të ndikojë ndjeshëm në perceptimin për takimet e juaja:
 - Shmangni titujt që mund të përçojnë pa dashje një ndjenjë të pamjaftueshmërisë ose gjykimit. Për shembull, "Shkolla e prindërimit" mund të nënkuptojë se prindërve u mungon njohuria ose kompetenca.
 - Siguroni që titujt tuaj të pasqyrojnë një qasje pozitive, të orientuar në të mësuarit.

5. Siguroni zgjidhje praktike

- Në përshkrimet e ngjarjeve tuaja, përqendrohuni në ofrimin e zgjidhjeve të prekshme për problemet me të cilat përballen prindërit:
 - Theksoni vlerën të cilën prindërit do t'a fitojnë përmes pjesëmarrjes. Çfarë do të mësojnë dhe si do t'i ndihmojë kjo në rrugëtimin e tyre prindëror?
 - Bëjeni të qartë përse është thelbësore që ata të marrin pjesë në këto ngjarje.

6. Përdorni gjuhë të qartë dhe të qasshme

- Komunikimi efektiv varet nga gjuha e folur të cilën mund ta kuptojnë të gjitha palët:
 - Komunikoni në një gjuhë që rezonon me prindërit, duke shmangur zhargonet profesionale.
 - Përdorni fraza të cilat prindërit zakonisht i përdorin për të përshkruar sfidat dhe shqetësimet e tyre.

7. Përfshini prindërit në planifikim

- Shfaqni përkushtimin tuaj për bashkëpunim duke përfshirë prindërit në procesin e planifikimit:
 - Lejojini prindërit të kenë fjalën në përcaktimin e kornizës kohore për takimet. Kërkoni kontributin e tyre në lidhje me oraret e preferuara për takimet dhe kohëzgjatjen ideale të punëtorive.

8. Demonstroni respekt

- **Është thelbësore të kuptoni se megjithëse mund të mos jeni në gjendje të përmbushni çdo kërkesë, shfaqja e interesit të vërtetë për nevojat e prindërve përcjell respekt:**

- Demonstrimi i gatishmërisë suaj për të dëgjuar dhe marrë parasysh kontributin e tyre mund të lërë një përshtypje të qëndrueshme pozitive.

2.6.2. Formoni një grup

1. Nuk mjafton një temë adekuate dhe një titull i mirë për të krijuar një grup prindërisht.

- Mos kini frikë t'u drejtoheni disa prindërve, një nga një. Thoni me pak fjalë se çfarë planifikoni dhe pse ajo është e rëndësishme. Pyetni prindërit: Çfarë thoni për temën tonë? A keni ndonjë ide? Cilin tjetër mendoni se duhet të pyesim?

- Krijoni ftesa ose porosi të personalizuar për prindërit. Drejtojuni atyre me emër dhe përmendni edhe fëmijën e tyre me emër. Ky kontakt personal mund t'i bëjë prindërit të ndihen të vlerësuar dhe më të prirur për të marrë pjesë.

- Theksoni përfitimet unike nga ngjarja për zhvillimin dhe përparimin akademik të fëmijës së tyre.

- Ndani historitë e suksesit ose dëshmitë e prindërve tjerë që kanë marrë pjesë në aktivitete të ngjashme për të shfaqur ndikimin e tyre pozitiv.

2. Programi prindërisht

- Themeloni një program "Prindërisht" ku prindërit entuziastë dhe të angazhuar, veçanërisht ata që kanë marrë pjesë më parë dhe kanë shijuar ngjarjet, dalin vullnetarë për të inkurajuar prindërit e tjerë për pjesëmarrje.

- Këta ambasadorë mund të ndajnë përvojat e tyre pozitive, t'u përgjigjen pyetjeve dhe t'u japin siguri prindërve hezitues.

- Inkurajoni ambasadorët të lidhen me prindërit përmes telefonatave, porosive ose mediave sociale dhe ftojini ata personalisht në aktivitetet e radhës.

Kjo qasje është shumë e ngjashme me bazat e punës sociale në komunitet. Së pari, kërkoni ata që janë të interesuar të përfshihen. Me to, krijoni një "bërthamë" përmes tyre. Këta prindër mund t'ju ndihmojnë të rrisni shpërndarjen e ndërgjegjësimit dhe madje edhe zbatimin e mëvonshëm.¹

3. Nxitja e qasjes gjithëpërfshirëse

- Njihni sfidat me të cilat mund të përballen prindërit nga shtresat e pafavorshme socio-ekonomike, siç janë burimet e kufizuara ose kufizimet kohore.

- Bashkëpunoni me organizata të komunitetit lokal ose organizata bamirëse për të ofruar mbështetje plotësuese, si transport/shërbime të kujdesit për fëmijët/vullnetarë, për ta bërë më të lehtë pjesëmarrjen e këtyre prindërve.

¹ Ruch, G. et al (2010). Puna sociale e bazuar në marrëdhënie: arritja në thelbin e praktikës. Londër: Jessica Kingsley publishers

2.6.3. Gjatë takimit/punëtorisë

Arrini atje të paktën gjysmë ore më herët.

1. Mirëpritni prindërit.

- Drejtohuni atyre me emër. Nëse është e mundur, siguroni distinktivë emrash ose letra ngjitëse në të cilat do të shkruhen emrat e pjesëmarrësve.

2. Përgatiteni hapësirën për punë.

- Mendoni të krijoni një hyrje të ngrohtë dhe tërheqëse në zonën ku mbahet punëtorja, në mënyrë që prindërit të ndihen të mirëpritur që në momentin që mbërrijnë.

- Merrni parasysh një ngjarje specifike, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për një punëtor që përfshin fëmijët dhe prindërit ose për një takim të caktuar vetëm për prindërit.

- Jini elastik për rregullime të ndryshme të ulëseve që mund të përshtaten me nevojat e çdo punëtorie. Për shembull, përdorni karrige dhe tavolina të lëvizshme që mund të vendosen në konfigurime të ndryshme. Mos këmbëngulmi për pozicionin rrethor ulur të karrigeve,

- Sigurohuni që ulëset të mundësojnë diskutime në grup dhe aktivitete individuale, pasi disa punëtorë mund të kërkojnë formate të ndryshme.

- Pajiseni hapësirën me mjete ndihmëse vizuale thelbësore, si tabela të bardha, tabela rrotulluese ose ekrane për prezantime.

- Sigurohuni që të ketë furnizime dhe materiale të mjaftueshme për aktivitete dhe demonstrime ndërvepruese.

- Krijoni një atmosferë të rehatshme duke siguruar ulëse me jastëk ose karrige ergonomike dhe siguroni ndriçimin e duhur. Nëse keni mundësi, siguroni karrige të mëdha për të gjithë prindërit.

- Sigurohuni që diskutimet të mos dëgjohen nga të tjerët në hapësirat e afërta.

- Krijoni një sistem për informim kthyes, siç janë kutitë për sugjerime ose anketa në internet, për të grumbulluar të dhëna nga prindërit në lidhje me hapësirën e punëtorisë dhe përvojën e përgjithshme.

3. Gjithmonë jini të vetëdijshëm për nivelin e njohurive, kapacitetin dhe specifikat e tjera të pjesëmarrësve të grupit dhe përshtatuni me nivelin e grupit.

4. Përshtatni teknikën. Portretizoni atë që thoni.

- Përdorimi i kufizuar i slajdeve, për shembull, pyetjet për prindërit, udhëzimet e seminarit, frazat e fjalive, vizatimet, fotografitë, animimet, filmat e shkurtër, videot e shkurtra, etj., mund të jenë të dobishme përderisa nuk e ulin angazhimin e pjesëmarrësve.

- Shmangni prezantimet e gjera në PowerPoint, pasi ato kanë tendencë të sinjalizojnë moderatorin si ekspert dhe mund të zvogëlojnë diskutimin.

5. Nëse është e mundur, sugjerohet që të ketë dy edukatorë/profesionistë.

- Nëse jeni duke filluar me një lloj të tillë punëtorie, këshillohet që të keni të pranishëm dy edukatorë ose profesionistë. Një edukator mund të marrë drejtimin gjatë sesionit ose një pjesë të tij dhe është përgjegjës për shpërndarjen e përmbajtjes, lehtësimin e angazhimit në grup dhe menaxhimin e aktiviteteve të lidhura. Ky edukator duhet të jetë gjithashtu i ndërgjegjshëm për kohëzgjatjen e sesionit.

- Roli i edukatorit të dytë është të mbështesë edukatorin kryesor dhe të luajë një rol më të spikatur në nxitjen e pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të grupit. Kjo përfshin mbikëqyrjen e dinamikës së grupit, të qenit të vëmendshëm ndaj çdo sfide më të cilën mund të përballen anëtarët e grupit, siç janë vështirësitë për të qenë të dëgjuar në mesin e pjesëmarrësve më të zëshëm. Edukatori i dytë

është veçanërisht i përshtatur me shenjat e shqetësimit emocional midis anëtarëve të grupit. Nëse një pjesëmarrës duhet të largohet përkohësisht nga sesiioni dhe kërkon mbështetje, zakonisht është edukatori i dytë ai që ofron ndihmë.

- Për më tepër, është e vlefshme nëse edukatorët janë të qashtëm gjatë pushimeve, pasi disa anëtarë të grupit mund të dëshirojnë të kërkojnë udhëzime ose të diskutojnë për tema të cilat nuk janë të rehatshëm t'i ndajnë brenda grupit.

2.6.4. Rregullat bazë për profesionistët që udhëheqin një grup

- Është e rëndësishme që pikëpamjet e të gjithëve të dëgjohen, vlerësohen dhe trajtohen me respekt. Prindërit duhet të ndihen rehat kur i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe edukatorit, por gjithmonë duhet pasur kujdes që individët të mos bëhen të izoluar apo me ankth. Tregoni respekt për të tjerët, veçanërisht duke respektuar dallimet dhe diversitetin.
- **Praktika kundër diskriminuese duhet të jetë e dukshme gjatë çdo ngjarjeje.** Përpiquni të arrini një ndjenjë të mirëseardhjes për pjesëmarrësit nga të gjitha kulturat, origjinat dhe llojet e familjes.
- **Mos bëj dëm. Pjesëmarrja e prindërve të fëmijëve në rrezik duhet të menaxhohet me kujdes në mënyrë që të minimizohen rreziqet ose pasojat negative për ata që janë të prekur.** Është e rëndësishme të kihet parasysh se hapja e diskutimit rreth temave dhe shqetësimeve të caktuara mund të jetë emocionuese dhe shumë e ndjeshme dhe duhet të menaxhohet dhe mbështetet me kujdes për të siguruar mirëqenien e pjesëmarrësve. - **Kini parasysh se loja me role mund të jetë shumë e dobishme, por gjithashtu krijon shumë ankth.** Nëse ka anëtarë të grupit me vetëbesim, mund të jetë e dobishme që lehtësuesit të demonstrojnë disa lojëra me role për të hulumtuar përvojat në lidhje me temën që diskutohet.
- **Trajtojini të gjitha punëtoritë dhe të gjitha diskutimet formale ose joformale si të besueshme.** Mund të ketë edhe diskutime joformale gjatë pushimeve, ku shkëmbehen çështje profesionale, personale ose familjare. Është shumë e rëndësishme që të respektohet privatësia e individëve dhe familjeve.
- Disa dilema rreth prindërimit nuk mund të diskutohen në terma të përgjithshëm, dhe kështu përvojat, prandaj shqetësimet specifike duhet të diskutohen gjatë takimeve individuale. **Është përgjegjësi e edukatorit që të sigurojë që grupi të qëndrojë "në rrugën e duhur", duke lejuar disa devijime, por më pas duke e udhëzuar butësisht përsëri kah tema aktuale.**
- Nëse ka një numër të madh konceptesh dhe teorish në përmbajtjen e takimit, edukatori do të duhet të bëjë një gjykim se sa thellë duhet të hyjë. **Disa prindër mund të përjashtohen për shkak të shkallës së përmbajtjes profesionale (për shembull, ligjet dhe statutet). Tregimet, metaforat, anekdotat personale dhe lidhja e ideve me përvojat e anëtarëve të grupit mund të ndihmojnë në zvogëlimin e natyrës intelektuale të teorisë së shkëmbimit dhe ta bëjnë atë të arritshme për të gjithë.**
- **Qëllimet e takimeve në grup arrihen më së miri kur pjesëmarrësit janë të angazhuar në mënyrë aktive, me shumë diskutime.** Gjithmonë do të ketë anëtarë më të qetë të grupit, por përgjegjësia e edukatorit është të sigurojë që të gjithë të ndihen të mirëpritur. Shpresohet që për anëtarët më të qetë të grupit do të jenë më të dobishme aktivitetet e grupeve të vogla në dhënien e kontributeve të tyre unike. Kombinoni punën me grupin në tërësi me aktivitetet e grupeve të vogla. Ato mund të jenë të dobishme për dhënie të

mundësisë për angazhim të anëtarëve më të qetë të grupit dhe gjithashtu për ofrim të një hulumtimi më të thellë të ideve.

- Pjesëmarrja funksionon më së miri kur lehtësuesit janë pjesë e grupit, të ulur brenda rrethit në vend që të qëndrojnë përpara.^{vi} Kjo qasje bashkëpunuese miraton se profesionistët nuk janë ekspertët e vetëm. Si prindërit ashtu edhe edukatorët kanë ekspertizë të vlefshme për të kontribuar në grup. Edukatorët mbajnë përgjegjësinë për ofrimin e ekspertizës në lidhje me përmbajtjen dhe proceset në grup, ndërsa prindërit sjellin ekspertizën e tyre personale që rrjedh nga përvojat e tyre të prindërimit. Shkrirja e këtyre formave të ndryshme të ekspertizës është ajo që fuqizon grupin. Profesionistët mësojnë vazhdimisht së bashku me pjesëmarrësit.

2.7. Përfshirja e prindërve dhe familjeve të fëmijëve në rrezik në punën e kopshteve

Ekzistojnë pesë lloje situatash ose ngjarjesh që mund të prodhojnë stres, dhe nga ana tjetër të kontribuojnë në një gjendje rreziku ose krize familjare ^{vii}:

1. **Situata familjare** — keqtrajtimi i fëmijëve, keqtrajtimi i bashkëshortit, shkurorëzimi, shtatzënia e paplanifikuar, braktisja e prindërve, martesë e fëmijëve, një anëtar i familjes me sëmundje kronike dhe mungesa e mbështetjes sociale për shkak të fesë, pakicës kombëtare ose seksuale.
2. **Situata ekonomike** — tendosje e papritur ose kronike financiare, si humbja e vendit të punës, shpenzimet e larta mjekësore, migrimi ekonomik, pagesat e munguara për mbështetjen e fëmijëve, varfëria, paratë e "humbura" në lojëra fati ose nga varësia prej drogës.
3. **Situata në komunitet** — dhuna, strehimi i papërshtatshëm, mungesa e burimeve në komunitet, programet joadekuate arsimore, mungesa e transportit publik.
Nëse jeni duke punuar me një grup prindërisht të fëmijëve të moshës së çerdhes ose fëmijëve me aftësi të kufizuara, mund të thoni, "Nëse mund të flisni, çfarë do të më thoni për nënën tuaj?"

Për më tepër, fjali të lidhur: "Ky ushtrim i ndihmon prindërit të fitojnë një kuptim më të thellë të perspektivave të fëmijëve të tyre dhe kultivon lidhje më të forta familjare."

² Mos këmbëngulni; nëse dikush nga pjesëmarrësit nuk dëshiron t'i mbyll sytë, mos e detyroni.

3.2.3. Njoftimi reciprok

Ky është një ushtrim shumë i lehtë, i dobishëm për zhvillimin e kohezionit në grup.

Koha: 15 minuta

Materialet e nevojshme: Asgjë

Kërkoni nga grupi: "Gjeni diçka në çantën ose portofolin tuaj që përfaqëson një pjesë tuajën që ne mund të mos e dimë dhe na tregoni diçka për të. Këto janë zakonisht foto, zinxhirë çelësash, karta anëtarësie, kuponë, etj.

3.2.4. Gjuetia e thesarit njerëzor

Ky aktivitet është i dobishëm për thyerjen e akullit. Për të gjetur karakteristikat e përbashkëta dhe pjesëmarrësit fillojnë të krijojnë një sistem mbështetës.

Koha: 20 minuta

Materialet e nevojshme: Komplet i gjuetisë së thesarit

Shpjegoni: "Ne po shkojmë në një gjueti thesari. Unë do t'ju jap një listë me 'thesare' ose karakteristika që mund të keni të përbashkëta me dikë tjetër."

Thuaju prindërve të zgjedhin një "thesar" që u përshtatet dhe të kërkojnë një partner me të njëjtin. (Ngrihuni dhe ecni nëpër dhomë dhe bisedoni me njerëzit derisa të gjeni dikë që ka të njëjtën pasuri.). Me "partnerin" bisedoni më shumë për pasurinë tuaj.⁴

U thoni prindërve të zgjedhin një "thesar" tjetër dhe të kërkojnë përsëri një partner.

Kompleti për kërkim të thesarit:5

Gjeni një partner që ndan me ju një nga këto "thesare":

Ai/ajo ka një fëmijë të birësuar

Është prind i vetëm

Ka katër ose më shumë fëmijë

Është gjyshe/gjysh

Ka një foshnjë

Ka një vajzë dy vjeçare

Ka një djalë dy vjeç

Është në pritje të një fëmije

Nuk punon

Ka një fëmijë mbi pesë vjeç

Dikur ka jetuar në një shtet tjetër

Ka një fëmijë që i pëlqen perimet

Ka një fëmijë që i urren perimet

⁴ Sugjerojuni prindërve që ata të shkëmbejnë numrat e telefonit, të ndajnë informacione, të mbështesin njëri-tjetrin në mënyra të tjera që ata zgjedhin.

⁵ Shtoni çdo gjë që dëshironi, gjëra që janë unike ose interesante në kontekstin specifik të kopshtit/çerdhës suaj.

3.3. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PRINDËRVE PËR BASHKËPUNIM DHE PARTNERITET ME KOPSHTET PËR FËMIJË;

3.3.1. Çfarë nënkupton përfshirja e prindërve?

Koha: 20 minuta
Resurset: nuk ka
Qëllimet: prindërve t'u prezantohet koncepti i përfshirjes së prindërve.
<p>Moderatori e definon shkurt përfshirjen e prindërve në kuadrin e marrëdhënieve familje-kopsht dhe shpjegon mënyrat e ndryshme në të cilat prindërit përfshihen në aktivitetet parashkollore.</p> <p>Përdorni pyetje joformale për të nxitur kujtimet e prindërve kur pritjet prej tyre të marrin pjesë ose të përfshihen në punën e çerdhës. Bëni pyetje vetëm për shembuj të situatave dhe ngjarjeve konkrete që kanë ndodhur në institucionin tuaj.</p> <p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa prej tyre kanë marrë pjesë në mbledhjet prindërore në kopshtin e tyre? • A mund të jeni të ftuar dhe të bashkoheni në organizimin e një ngjarjeje për gjyshërit? Çfarë do të bëni atëherë? Cilat janë përshtypjet tuaja? • Vitin e kaluar një numër i madh prindërisht u përfshinë në një aksion për dekorimin e oborrit. A ka qenë ndonjë prej jush i përfshirë? • Disa prej jush duhet të jenë takuar me psikologun tonë dhe të kenë diskutuar disa dilema të prindërimit ose të kenë marrë pjesë në një seminar për prindërimin? <p>Kërkojuni pjesëmarrësve të rrëfejnë ose të ndajnë përvojat e tyre.</p> <p>Lejojini pjesëmarrësit të ndajnë kuptimet dhe përvojat e tyre për përfshirjen e prindërve. Jepni komente kthyes mbi atë që thonë pjesëmarrësit pa gjykuar ose miratuar/mospranuar saktësinë/pasaktësinë e përgjigjeve të tyre.</p>

3.3.1.1. Doracak: Përfshirja e prindërve

Përfshirja e prindërve është një praktikë e planifikuar sistematike në kopshtin e fëmijëve, që do të thotë se është përgjegjësi e kopshtit të identifikojë, të rrisë mundësitë dhe të nis procese përkatëse kontekstuale për të krijuar programe që përfshijnë prindërit në edukimin e fëmijëve të tyre, si dhe prioritetet dhe aktivitetet më të gjera në kopsht.

Nuk është gjithmonë e lehtë të thjeshtosh saktësisht se çfarë nënkupton përfshirja e prindërve. Kjo bëhet kur merren parasysh politikat ekzistuese arsimore, rrjeti institucional dhe dinamika e brendshme, por edhe (pa)qasshmëria e familjeve, strukturat, sfondi kulturor.

Megjithatë, ajo që mund të bëjmë është të konsiderojmë se përfshirja e prindërve në punën e kopshtit duhet të përfshijë nivele të ndryshme të përfshirjes:

Informimi - (p.sh. njoftimi për ngjarjet aktuale, procedurat, raportet ditore dhe kontakti me prindërit)

Konsultimi - (p.sh. biseda me prindërit për të gjitha situatat, jo vetëm ato problematike.)

Vendimmarrja e përbashkët - (p.sh. takimi i prindërve, grupet e diskutimit, këshilli i prindërve...)

Aktivitetet e përbashkëta - (p.sh. qëndrimi i prindërve në grup, aktivitete vullnetare në një kopsht fëmijësh, veprime të përbashkëta në komunitetin lokal.

Ose mund të mendojmë në lidhje me aktivitete të ndryshme:

- **Kontakti ditor.** Prindërit dhe profesionistët duhet të shkëmbejnë informacione çdo ditë që nga dita e parë e qëndrimit të fëmijës në kopsht. Mund të ndihmojnë tabelat e buletinit, fletorja/ditari për shtëpi-çerdhe, grupet viber, organizimi i brendshëm i transferimit të informacionit ndërmjet edukatores dhe prindërve.
- **Takime "një me një" me prindër.** Mbledhjet nuk duhet të mbahen vetëm në rast konflikti ose në fillim ose në fund të vitit shkollor. Mbani ato për t'u lidhur me prindërit, për të qenë kurioz për jetën e fëmijës ose për të ndarë informacione rreth fëmijës dhe për të njohur çdo familje specifike. Lehtësojini prindërit që të organizohen për takime. Jini të hapur ndaj opsioneve në internet (Zoom, Skype...) për takime individuale. Nëse prindi jep pëlqimin, takimet mund të regjistrohen dhe dërgohen tek ai dhe regjistrimi gjithashtu mbetet në arkivin parashkollor.
- **Takimet në grup. Duhet evituar modeli** e njëanshme, ku profesionisti është i vetmi që flet. Takimet në grup mund të përdoren për të njohur prindërit, për të ndarë informacione, për të hartuar nevojat e prindërve tuaj, për të planifikuar, për të lidhur prindërit me çështje të ngjashme, sfida dhe më shumë.
- **Përfshirja në aktivitetet e grupit parashkollor.** Prindërit dhe familjet mund të marrin pjesë në institucionin parashkollor gjatë procesit të përshtatjes, në punëtori të ndryshme, udhëtime shkollore, biseda, mëngjese të përbashkëta, klube librash, vullnetarizëm, shkuarje në park, aktivitete "prindi i vjetër që ndihmon prindin e ri"...
- **Përfshirja në punën e institucionit parashkollor dhe organizimit të tij.** Bashkëpunimi në një nivel më formal nëpërmjet pjesëmarrjes në ekipet dhe organet e kopshtit (këshilli i prindërve, këshilli drejtues)
- **Përfshirja në aktivitete të përbashkëta në komunitetin lokal** - mbështetje ose vullnetarizëm në një aktivitet të organizuar nga një institucion ose organizatë në komunitetin lokal
- **Vizitat në shtëpi** – Për shembull një vizitë e tërë grupit në lagjen ku jeton njëri nga fëmijët (p.sh. një fëmijë i ri në grup) ndërsa një prind mund të jetë një "guidë turistike" nëpër lagje, ose vizitat mund të jenë këshillëdhënëse dhe informuese në përputhje me nevojat e prindërve.

3.3.2. Pse është e rëndësishme përfshirja e prindërve?

Koha: 20 minuta

Resurse: Flip çart (tabelë trekëmbësh), tabelë me fije letre, markera

Qëllimet: të hulumtohen përfitimet e përfshirjes dhe bashkëpunimit të prindërve

Kërkojuni pjesëmarrësve të kalojnë disa minuta duke menduar për përfitimet e bashkëpunimit prindër-kopsht dhe të përpiqen të ofrojnë sa më shumë përgjigje pyetjeve të mëposhtme.

- 1) Cilat janë përfitimet për fëmijët nga bashkëpunimi midis prindërve dhe kopshtit?
- 2) Cilat janë përfitimet për prindërit dhe familjet nga bashkëpunimi prindër-kopsht?

3) Cilat janë përfitimet për profesionistët nga bashkëpunimi midis prindërve dhe kopshtit?

Mund t'i ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla për të diskutuar përgjigjet.
Moderatori i shënon përgjigjet në flip çart.

3.3.3. Përmirësimi i bashkëpunimit midis kopshtit për fëmijë dhe familjes.

Koha: 40 minuta

Resurset: Flip çart - tabelë me fletë, markera

Qëllimet: Të hulumtojë se si prindërit i shohin pengesat për përfshirjen e prindërve në punën dhe vendimmarrjen në kopshte. Të shqyrtohen mënyra për të përmirësuar më tej marrëdhëniet mes familjes dhe kopshtit.

Jepuni pjesëmarrësve disa minuta të mendojnë për pengesat e bashkëpunimit prind-kopsht.

Cilat mund të jenë sfidat ose pengesat për përfshirjen e prindërve?

Shkruani përgjigjet në tabelën e flip çartit. Mund t'ju duhet të jepni disa shembuj për të nisur grupin: Komunikimi i dobët

- Mungesa e informacionit
- Koha e papërshtatshme e takimeve me prindër

Nëse jeni duke punuar me një grup pjesëmarrësish, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në kopsht për një kohë më të gjatë, atëherë vazhdoni aktivitetin.

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe jepuni 10 minuta për të diskutuar pyetjet e mëposhtme.

- Çfarë duhet të bëjë kopshti për t'ju inkurajuar si prind që të përfshihen më shumë në punën e kopshtit?
- Cilët janë shembujt e përfshirjes së mirë që ekzistojnë tashmë në kopshtin e fëmijëve?
- Çfarë do të bënit për të ndryshuar mënyrat ekzistuese të përfshirjes së prindërve në kopshtin e fëmijëve?

Njoftoni pjesëmarrësit se njëri pjesëmarrës do të flasë ndërsa të tjerët dëgjojnë dhe shkruajnë përgjigjet në tabelën flip çart.

3.3.4. Të drejtat dhe përgjegjësitë

Ky aktivitet hulumton të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve për bashkëpunim dhe partneritet me kopshtet.

Koha: 60 minuta

Materialet e nevojshme: letër flip çarti për të bërë një vizatim të një fëmije në madhësi reale; markera ose shkumësa me ngjyra, ngjitëse (opsionale)

Përgatitni një skicë të trupit të njeriut në një letër të flip çartit (hamer). Bëni skicën gjinore neutrale. Ose kërkoni nga një vullnetar që të shtrihet në një copë letre të madhe në dyshe dhe vizatoni konturat e trupit të tij.

Shpjegoni se vizatimi i trupit do të përdoret për të treguar të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve.

Prindërit mendojnë në mënyrë intensive për të gjitha të drejtat që mendojnë se duhet të kenë. Të gjitha këto sugjerime moderatorit i shkruan në “trupin e vizatuar” me një stilolaps një ngjyrë.

Mandej, u kërkohet prindërve të listojnë përgjegjësitë që kanë. Për t'i ndihmuar, tregojuni se shumë të drejta përbëjnë përgjegjësi përkatëse, për shembull, e drejta për t'u shprehur dhe përgjegjësia për të dëgjuar. Shkruani përgjigjet e prindërve në hamer (jashtë trupit).

Referojuni prindërve materialin që përshkruan të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre ose në një dokument zyrtar të kopshtit tuaj ose në pjesë të ligjit që rregullon këto çështje. Hapni debat në nivel grupi për atë se sa i ngjashëm ose i ndryshëm është ai dokument me atë që kanë listuar prindërit.

* Këtu mund të bëni një pushim të shkurtër.

Lexoni me kujdes të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që prindërit i kanë shkruar në trup.

Kërkojini secilit prind të votojë për tre të drejta që janë më të rëndësishme për ta. Prindi mund të bëjë tre pika pranë tre vijave të ndryshme me një stilolaps me ngjyra të ndryshme, ose nëse është e mundur, t'i japë secilit prind tre ngjitëse.⁶

Në këtë mënyrë, aktiviteti nxit një kuptim më të thellë të roleve të prindërve dhe nxit diskutime produktive për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në kuadrin e institucioneve parashkollore.

Zgjidhni tre të drejtat që kanë fituar më shumë vota dhe diskutoni:

- A janë të befashuar nga përgjigjet? Në çfarë mënyre?
- Sipas tyre, a mund të ishte përfshirë ndonjë e drejtë tjetër në tre të parat?
- Si mund të realizohet kjo e drejtë, për shembull: Çfarë duhet të ndodhë që prindërit të kenë të drejtën të zgjedhin ushqimin për fëmijët e tyre çdo ditë?

3.3.5. Bashkëpunimi

Përcaktimi i kriterëve specifike, të shkruara në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.

Sugjerohet që ky aktivitet të zhvillohet pas aktivitetit “Të Drejtat dhe Përgjegjësitë”. Nëse nuk ndodh, atëherë ndajini materialet e shtypura me të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve.

Bashkëpunimi është një rrugë e dyanshme – të drejtat dhe përgjegjësitë vlejné si për prindërit ashtu edhe për profesionistët.

Koha: 40 minuta

Materialet e nevojshme: letër, lapsa, hamer

Ndani prindërit në grupe me 3-4 pjesëmarrës.

⁶ Nëse prindërit nuk dinë shkrim-lexim, atëherë mund të krijoni simbole për të drejtat e ndryshme. Sigurohuni që prindërit të mund të identifikojnë lehtësisht se çfarë përfaqësojnë simbolet. Më pas prindërit i tregojnë moderatorit se për cilat të drejta duan të votojnë dhe moderatorit u tregon se ku të vendosin shenjën ose ngjitësin.

Kërkojini secilit prind të shkruajë dy të drejta dhe dy përgjegjësi që janë më të rëndësishme për ta. Shembuj: Respekti dhe komunikimi i qartë.

Nxitini ata të ndajnë atë që kanë vërejtur brenda grupeve të tyre përkatëse dhe të theksojnë dy të drejtat më të rëndësishme dhe dy përgjegjësitë më të rëndësishme në nivel grupi.

Kërkojuni pjesëmarrësve të përpunojnë këto të drejta dhe përgjegjësi në grup duke i shprehur ato në terma të matshëm.

Mund të thoni: Pyesni veten, si do ta kuptoni se jeni të respektuar? Si duhet të sillemi që të tjerët të ndihen të respektuar?

Grupi të listojë sa më shumë përgjigje konkrete.

Shkruani përgjigjet në tabelë. Mund ta ndani tabelën në dy pjesë, një me fjalët "të drejtat" dhe një me fjalët "përgjegjësitë". Moderatorin mund të drejtojë dhe përmbledhë përgjigjet, si dhe të ofrojë sugjerimet e duhura.

Për shembull, Përgjegjësia - Respekt - t'i shkruhen mesazhe edukatorit vetëm në ditët e punës.

Së bashku me grupin, formuloni rregulla sa më konkrete për bashkëpunim.

- Diskutoni se si janë ndjerë prindërit gjatë këtij aktiviteti.
- Çfarë njohurish të reja kanë fituar?
- Cilat mendoni se mund të jenë pengesat për zbatimin e këtyre rregullave të bashkëpunimit?

3.4. FORMA TË NDRYSHME PËR PËRFSHIRJEN E PRINDËRVE/FAMILJEVE;

3.4.1. Çfarë mund të jetë përfshirje e prindërve?

Koha: 40 minuta

Materialet e nevojshme: letër, stilolaps, material i printuar – Tipologjia e përfshirjes së prindërve sipas Epstein.

Ndani pjesëmarrësit në grupe me 3-4 anëtarë. Secili grup merr një kopje të materialit të printuar – Tipologjia e Epstein të Përfshirjes së Prindërve.

Duhet të ketë të paktën gjashtë grupe. Secilit grup i jepet detyra të shtjellojë më hollësisht një lloj aktiviteti nga tipologjia.

Kërkojuni prindërve të përpiqen të listojnë sa më shumë mënyra konkrete të përfshirjes që të jetë e mundur që do të ndërlihdeshin me një lloj aktiviteti të caktuar.

Inkurajoni prindërit që është në rregull të ndajnë idetë dhe sugjerimet e tyre.

Ndani përgjigjet në nivel grupi. Moderatorin i shkruan në tabelë, i përmbledh dhe i komenton.

3.4.1.1 Materialet Tipologjia Epstein e përfshirjes së prindërve

Autori Epstein (2001) ka zhvilluar një tipologji të përfshirjes së prindërve në arsimin e fëmijëve, duke theksuar gjashtë llojet e mëposhtme të aktiviteteve:

1. (Tipi 1) – prindërimi – aktivitetet e prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjes që ofrojnë një mjedis të sigurt stimulues për rritje, zhvillim dhe mësim në formën e strehimit, kujdesit shëndetësor, ushqimit adekuat, sigurisë, ndërveprimeve të përditshme të të rriturve me fëmijët aktivitete stimuluese për mësim;
2. (Tipi 2) – komunikimi me institucionin arsimor – aktivitete të ndryshme të prindërve në kuadër të shkëmbimit të dyanshëm të informacionit me mësimdhënësit dhe punonjësit e tjerë për ngjarjet aktuale në shkollë dhe përparimin e përgjithshëm të fëmijës;
3. (Tipi 3) – vullnetarizmi – përfshirja e prindërve në aktivitete mbështetëse dhe ndihmëse në projekte të ndryshme me qëllim modelimin e sjelljes së fëmijëve ose përmirësimin e kushteve të të nxëniet përmes përfshirjes personale në aktivitete rekreative dhe aktivitete të tjera në kopsht;
4. (Tipi 4) – mbështetja në shtëpi – aktivitete në të cilat prindërit mbështesin më tej mësimin e fëmijës dhe inkurajojnë përparimin e tij duke folur për tema që kanë të bëjnë me mësimin dhe lojën në kopsht;
5. (Tipi 5) – vendimmarrja – përfshirja e prindërve në vendimmarrje për çështje të rëndësishme për cilësinë e punës në kopshte drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet organeve të ndryshme;
6. (Tipi 6) – bashkëpunimi me komunitetin – angazhimi i prindërve në identifikimin e shërbimeve dhe burimeve në komunitet që mund të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit të të mësuarit për çdo fëmijë që ka nevojë për mbështetje në zhvillim dhe mësim.

3.4.2. Mbështetje për fëmijët

Koha: 30 minuta

Resurset: tabelë me letër flip çarti, markera

Qëllimet: të hulumtohen lloje të ndryshme të përfshirjes dhe bashkëpunimit me prindërit.

Thuajuni pjesëmarrësve se mbështetja e prindërve është shumë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës.

Kërkoni nga pjesëmarrësit të mendojnë për disa minuta për gjëra të ndryshme që prindërit dhe anëtarët e familjes bëjnë në shtëpi për të mbështetur dhe ndihmuar zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve.

Mund të pyesni: Çfarë kanë bërë prindërit tuaj dhe anëtarët e familjes për t'ju mbështetur që të rriteni si person?

Shkruani përgjigjet në tabelë. Mund t'ju duhet të jepni shembuj konkret për të nisur grupin:

Më ndihmonin të shkruaj detyrat e shtëpisë

Më lexonin

Më mbështetnin financiarisht

Bënin tortë për ditëlindjen time

I shkruanin detyrat e shtëpisë së bashku me mua ...

Thuajuni pjesëmarrësve se përfshirja në punën e kopshtit mund të jetë gjithashtu një mënyrë për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve. Mund të listoni shkurt disa nga përfitimet e një fëmije për të pasur një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të mirë.

Kërkoni nga pjesëmarrësit të kalojnë disa minuta duke menduar për gjërat e ndryshme që prindërit dhe familjet bëjnë në kopshtin e fëmijëve për të mbështetur dhe ndihmuar fëmijët e tyre të rriten dhe zhvillohen?

Shkruani përgjigjet në tabelën e flip çartit.

3.4.3 Modelimi i të ardhmes së kopshtit tonë

Koha: 45 min

Resurset: letër flip çarti, markera

Qëllimet: Të nxiten prindërit që të marrin pjesë aktive në proceset vendimmarrëse në kopsht dhe të hulumtojnë mënyra të ndryshme për të cilat mund të kontribuojnë.

Filloni me një mirëseardhje dhe prezantim të ngrohtë. Ndani qëllimet e seminarit dhe rëndësinë e përfshirjes së prindërve në kujdesin ditor.

Ndajini prindërit në grupe të vogla dhe siguroni atyre skenarë ose studime rasti në lidhje me vendimet e qëndrimeve ditore (p.sh., plan programe, ngjarje, politika). Nxitini ata të diskutojnë dhe të ofrojnë ide për zgjidhje ose ide të mundshme.

Secili grup paraqet idetë e tij dhe diskuton njohuritë e tij. Kjo u mundëson prindërve të mësojnë nga njëri-tjetri.

Nëse jeni të zotë dhe njihni prindër, mund t'i përfshini prindërit në një aktivitet me role, ku ata simulojnë një takim vendimmarrës. Kjo mund t'i ndihmojë ata të praktikojnë aftësitë efektive të komunikimit dhe negocimit.

Mblidhni komente kthyesë prindërit në lidhje me seminarin dhe atë që ata planifikojnë të zbatojnë në përfshirjen e tyre në kopsht. Përpiloni së bashku një plan veprimi.

3.4.4. Dita e familjes: Marrja e vendimeve së bashku

Koha: 60 min

Resurset: flip çart, markera

Qëllimet: Të përfshihen prindërit dhe fëmijët në procesin e vendimmarrjes dhe të forcohet marrëdhënia prind-fëmijë duke hulumtuar forma të ndryshme të përfshirjes.

Filloni me aktivitete argëtuese që nxisin lidhjen prindër-fëmijë, p.sh., projekte arti dhe artizanale ose lojëra në ekip.

Ndani një histori ose video të shkurtër ose lexoni një histori për një familje që merr vendime të rëndësishme së bashku. Diskutoni rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në zgjedhjet e familjes.

Ndani familjet në grupe, secila me prindër dhe fëmijë. Jepni një skenar të përshtatshëm për kopshtin (për shembull, zgjedhja e një teme për një ngjarje ose udhëtim në terren) dhe lëri ata të vendosin si ekip.

Secili grup paraqet vendimet e tij dhe shpjegon procesin e tyre të të menduarit. Inkurajoni diskutime krijuese dhe të hapura.

Përfshini prindërit dhe fëmijët në një projekt të përbashkët arti për të simbolizuar unitetin dhe bashkëpunimin si familje.

Përfundoni duke diskutuar se si kjo përvojë mund të zbatohet në familjet e tyre, si dhe përfshirja në kujdesin parashkollor. Inkurajoni prindërit dhe fëmijët që të angazhohen për pjesëmarrje aktive në procesin e vendimmarrjes së kopshtit.

3.5 INKURAJIMI I PËRFSHIRJES SË BABALLARËVE

Shënime për moderatori

Vini re se termi "baba" i referohet baballarëve dhe burrave të tjerë që luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e një fëmije. Ai person mund të jetë babai biologjik, prindi birësues, kujdestari ose njerku. Mund të jetë gjithashtu një gjysh ose një anëtar tjetër i rritur i familjes ose mik i ngushtë.

Pavarësisht nga përkatësia etnike apo statusi socio-ekonomik, shumica e baballarëve tradicionalisht janë më pak të përfshirë në këto çështje sesa nënat.

Para se të organizoni punëtoritë, do të ishte mirë t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve brenda institucionit tuaj. Ato mund t'ju ndihmojnë të planifikoni punëtoritë e baballarëve më lehtë dhe me efikasitet.

1. Si e ushqeni në mënyrë aktive interesin e baballarëve për t'u përfshirë në punën e kopshtit?
2. Në cilat ngjarje dhe aktivitete në kopshtin tuaj janë më të përfshirë baballarët - si pjesëmarrës? Si vullnetarë? Si organizatorë?
3. A bën kopshti juaj përpjekje konkrete për t'i përfshirë baballarët më shumë si vullnetarë, pjesëmarrës apo organizatorë?
4. A ka tashmë programe, ngjarje apo aktivitete që synojnë posaçërisht baballarët në kopshtin tuaj apo në komunitetin tuaj?
5. Si e dini se po përmbushni nevojat, shqetësimet dhe interesat e baballarëve në kopshtin tuaj?
6. Në çfarë kohe mbahen punëtoritë?
7. Çfarë shqetësimesh, sfidash hasni në përpjekjet tuaja për të përfshirë më shumë baballarët?
8. Cilat janë përfitimet e mundshme – për fëmijët dhe familjet, për edukatorët e kopshteve dhe për kopshtet me përfshirje më të madhe të baballarëve?

Gjithashtu, disa nga projektet e konsideruara për përfshirje më aktive të baballarëve në arsimimin e fëmijëve të tyre ofruan rekomandime domethënëse që është mirë të mbahen parasysh.

- Baballarët më shpesh zgjedhin të përfshihen në projekte aktive, në vend që të vijnë thjesht në takime në të cilat ata luajnë një rol pasiv. Ato janë më të përshtatshmit për projekte ku mund të përdorin aftësitë e tyre, si p.sh. të bëjnë pajisje për kënd lojërash, të mbikëqyrin ngjarjet sportive, të pikturojnë ose të lëvizin mobilje.
- Mos harroni rëndësinë e roleve, pritjeve dhe stereotipeve gjinore. Mbani në mend se disa baballarë preferojnë të punojnë dhe të shoqërohen me burra të tjerë, ata mund të mos ndihen rehat të diskutojnë disa tema personale me gratë.
- Mendoni për aktivitetet në të cilat baballarët janë të përfshirë në mënyrë aktive me fëmijët e tyre. Programet dhe punëtoritë e zhvillimit të aftësive jetësore zakonisht tërheqin burrat dhe për këtë arsye u hapin dyert burrave që të përfshihen në edukimin e fëmijëve të tyre.
- Mbani parasysh orarin e punës së baballarëve dhe organizoni ngjarje në përputhje me kohën e tyre të lirë.

3.5.1. Roli i babait

Koha: 30 minuta

Burimet: Tabelë flip çart me fije, letër

Qëllimet: Baballarët identifikohen në jetën e fëmijëve me rolin e babait.

Kërkojuni pjesëmarrësve të shkruajnë përgjigje për pyetjet e mëposhtme:

- Cila është detyra e babait në jetën e fëmijës?
- Çfarë kanë mësuar nga babai i tyre?
- Çfarë do të dëshironit që fëmijët tuaj të mësonin?

Diskutoni këto pyetje në një grup të madh.

3.5.2. Dikur dhe sot

Koha: 30 minuta

Burimet: tabelë flip çart me letër, markera, letër

Qëllimet: Si identifikohen baballarët me ndryshimin e pritur në rolin e babait.

Kërkojuni pjesëmarrësve të shkruajnë përgjigjet e tyre për këto pyetje:

- Si ndryshon të qenit baba tani që nga koha kur ju ishit fëmijë?
- Shkruani dy ngjashmëri dhe dy dallime rreth mënyrës se si ju ka trajtuar babai juaj dhe si e trajtoni fëmijën tuaj.

Diskutoni përgjigjet në një grup të madh.

3.5.3. Përgjegjësi të përbashkëta

Koha: 30 minuta

Burimet: tabelë flip çart me letër, markera, letër

Qëllimet: dallimet në rritjen e fëmijëve nga baballarët dhe nënat

Shpjegoni shkurt se çfarë do të thotë termi - rritje.

Kërkojuni pjesëmarrësve të kalojnë disa minuta duke menduar për karakteristikat e rritjes së fëmijëve dhe se si ato janë të përbashkëta për burrat/baballarët dhe gratë/nënat.

Shkruani përgjigjet në tabelë. Mund t'ju duhet të jepni disa shembuj për të filluar grupin:

Shprehje dashurie

Inkurajim

Përqaqim

Ambient i kufizuar

Të dëgjuar

Pyetni pjesëmarrësit nëse mund të identifikojnë karakteristikat e rritjes që janë më të zakonshme për burrat dhe më të zakonshme për gratë.

3.5.4. Vlerat

Koha: 45 minuta

Resurset: Flip çart, markera, materiale të printuara për të gjithë pjesëmarrësit

Qëllimet: Baballarët përcaktojnë vlerat, sjelljet dhe karakteristikat që duan të kultivojnë te fëmijët e tyre.

1. Filloni me: Baballarët janë shumë të rëndësishëm në jetën e fëmijëve të tyre. Ju luani një rol të madh në mënyrën se si fëmija juaj rritet dhe zhvillohet. Është e rëndësishme të dini se cilat sjellje apo cilësi vlerësoni tek një fëmijë dhe mendoni me kujdes se si i përcillni këto vlera. Pyetni ose kujtoni pjesëmarrësit se çfarë është një vlerë. (Ndonjëherë ajo që ju besoni është e rëndësishme dhe shpesh udhëheq sjelljen tuaj)
Jepni një shembull të një vlere (Ndershmëria).
2. Kërkojuni baballarëve të shikojnë deklaratën në materialin e shtypur dhe të zgjedhin 5 fjali që përfaqësojnë vlerat më të rëndësishme për ta.
3. Pastaj, filloni diskutim, parashtroni disa nga pyetjet e mëposhtme:
 - Çfarë ishte ai aktivitet për ju? Ishte e vështirë apo e lehtë të zgjidhje vetëm 5 fjali/vlera?
 - Pse zgjodhët një sjellje apo karakteristikë të veçantë?
 - A do të zgjidhnit vlera të ndryshme nëse fëmija juaj ishte i gjinisë së kundërt (p.sh. nëse djali juaj ishte vajzë ose vajza juaj ishte djalë)? Pse ose pse jo?
 - Cilat ishin tre sjelljet apo karakteristikat (vlerat) më të njohura? Pse mendoni se zgjidhen kaq shpesh ato?
 - Çfarë i nevojitet një fëmije për të zhvilluar sjelljet dhe karakteristikat që keni zgjedhur? Për shembull, çfarë do ta ndihmojë një fëmijë të jetë një nxënës i mirë? (Të vlerësojë mendjen dhe të marrë nota të mira, të ketë zakone të mira mësimi, të kënaqet me leximin, të jetë i kujdesshëm dhe të bëjë pyetje.)

Thuajuni pjesëmarrësve se fëmijët mësojnë vlerat duke na parë ne të rriturit.

Pjesëmarrësve mund t'u lëshoni një video të shkurtër për baballarët.

Sugjerim: <https://www.youtube.com/watch?v=htgPh3DalmM> ose ndonjë video edukative që ju duket e përshtatshme. Ofroni përkthim për videon në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit ta kuptojnë atë.

- Si përqipeni t'i inkurajoni këta karaktere te fëmijët tuaj?
- Çfarë mësojnë fëmijët tuaj kur përfshihen në punën e kopshtit? (jep një shembull: vullnetarizmi në një kopsht fëmijësh, ardhja në mbledhjen prindërore...)

4.5.4.1. Materiali - "Ajo që vlerësoj tek fëmija im"

- Një fëmijë që është i bindur.
- Një fëmijë që është kureshtar.
- Një fëmijë që më dëgjon gjithmonë.
- Një fëmijë i shkathët.
- Një fëmijë që nuk reziston kurrë.
- Një fëmijë që është i hapur dhe ndan me mua mendimet dhe ndjenjat e tij.
- Një fëmijë që ka shumë miq.
- Një fëmijë që është i ndershëm.
- Një fëmijë që vlerëson familjen.
- Një fëmijë që mund të kontrollojë temperamentin e tij.
- Një fëmijë që mund të mbrojë veten.
- Një fëmijë që është udhëheqës.
- Një fëmijë që ka pamje të mirë.
- Një fëmijë që do të jetë një nxënës i mirë.
- Një fëmijë i cili është fizikisht i aftë dhe i shëndetshëm.
- Një fëmijë që do të ndjekë bindjet e mia fetare.
- Një fëmijë i respektueshëm.
- Një fëmijë që ndihet mirë në lëkurën e tij.
- Një fëmijë që është i mirë në sport.
- Një fëmijë që është i lumtur.
- Një fëmijë që është ambicioz.

3.5.5. Vizioni për një baba

Koha: 20 minuta

Resurset: asgjë

Qëllimet: Të hulumtojnë efektet afatgjata të një roli aktiv në jetën e një fëmije

Thuajuni pjesëmarrësve: Imagjinoni 20 vjet nga sot se si fëmijët tuaj ftohen të marrin pjesë në një dokumentar për baballarët e tyre. Imagjinoni sikur regjisori t'u kërkonte të përshkruanin se çfarë baba ishit, si ishte të rritet me ty. Duke pasur parasysh këtë skenar, ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

1. Mendoni disa minuta vetë për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve me shkrim.

a) Njëzet vjet nga tani, cilat janë disa gjëra që shpresoni se do të thotë fëmija juaj për ju si baba?

b) Çfarë gjërash shpresoni që ai të mos i thotë për ju si baba?

c) A ka ndonjë gjë që mund të ndryshoni, pak a shumë, për të qenë një baba më i mirë?

ç) Si mund t'ju ndihmojë përfshirja në punën e kopshti të fëmijëve të bëheni një baba më i mirë?

Rekomandim: mund ta shikoni këtë video të shkurtër me grupin:

<https://www.youtube.com/watch?v=aSnKNXuw5TE>

3.5.6. Përfshirja

Koha: 20 minuta

Resurset: asgjë

Qëllimet: Hulumtoni mënyra konkrete për t'u përfshirë në punën e kopshtit

Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë për pyetjet e mëposhtme.

- Gjërat që ju pëlqen të bëni me fëmijën/fëmijët tuaj;
- Gjërat që ju pëlqen të bëni me baballarët/fëmijët e tjerë? Familje të tjera?
- Tema/aktivitete për baballarët në kopsht në të cilat dëshironi të merrni pjesë?

Diskutoni përgjigjet në një grup të madh.

3.6 MBËSHTETJA SHITESË PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE NË RREZIK DHE TË CENUESHËM NGA PËRJASHTIMI.

3.6.1. Çfarë është për ju mbështetja?

Koha: 20 minuta

Resurset: asnjë

Qëllimet: Hulumtoni pengesat konkrete dhe nevojën për mbështetje në kopshtin e fëmijëve

Kërkojuni pjesëmarrësve të marrin në konsideratë pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë pengesat për përfshirjen tuaj aktive në kopshtin e fëmijëve?
- Çfarë gjëje të dobishme duhet të bëjë kopshti që të nxit bashkëpunimin tuaj?

Shkruani përgjigjen në tabelën e flip çartit.

Diskutoni përgjigjet në një grup të madh.

3.6.2. Mësimi nga e kaluara

Koha: 30 minuta

Burimet: asgjë

Qëllimet: Hulumtimi i cilësisë së marrëdhënies që duam të arrijmë nga bashkëpunimi midis prindërve dhe profesionistëve që punojnë në kopsht.

Kërkojuni prindërve të kujtojnë përvojat e punës me profesionistë në sistemin arsimor, shëndetësor ose të kujdesit social. Mund të jetë një lidhje afatgjatë ose një lidhje tepër e shkurtër.

Kërkojuni pjesëmarrësve të bëjnë një listë të të gjitha gjërave që profesionistët i kanë përmendur, për të cilat mendojnë se më shumë i kanë lënduar sesa i kanë ndihmuar. Kërkojuni atyre të jenë konkret, për shembull, të kritikojnë.
(Jepuni një deri dy minuta)

Kërkojuni pjesëmarrësve të bëjnë një listë të të gjitha gjërave që profesionistët i kanë përmendur dhe që i kanë ndihmuar. Kërkojuni atyre të jenë konkret për gjërat që profesionistët kanë thënë që ata mendojnë se i ndihmuan ose i kanë përforcuar (edhe nëse ato gjëra nuk janë dukur të dobishme në atë kohë). (Jepuni një ose dy minuta.)

Ftojini pjesëmarrësit të ndahen në çifte dhe treshe për të diskutuar listat e tyre për dy ose tre minuta.

Në tabelën flip chart, bëni dy kolona me titujt e mëposhtëm: "Bashkëpunim joefektiv" dhe "Bashkëpunim efektiv". Kërkojuni grupit t'i diskutojë ato në një grup të madh.

3.6.3. Angazhimi prindëror për përfshirje

Koha: 120 min

Burimet: flip çart, markera, stilolapsa dhe letër

Qëllimet: Të ndërgjegjësohet për rëndësinë e përfshirjes aktive të prindërve në proceset e vendim-marrëse dhe aktivitetet në kopsht. Këtu përqendrohemi në mënyrën se si prindërit mund të kontribuojnë në mirëqenien e fëmijëve të tyre dhe të komunitetit më të gjerë.

- Urdhëroni prindër dhe përfshihuni në thyerjen e akullit në grup për të krijuar një atmosferë të rehatshme.

2. Kuptimi i barrierave/pengesave

- Kërkojuni prindërve të identifikojnë dhe diskutojnë sfidat me të cilat përballen në përfshirjen aktive në jetën e fëmijës së tyre në kopsht.

- Lehtësimi i shkëmbimit të përvojave dhe zgjidhjeve për barrierat e përbashkëta.

- Bëni një listë të sfidave të zakonshme në një letër flip çarti ose tabelë të bardhë.

3. Tejkalimi i stigmës

- Diskutim i hapur mbi stigmat sfiduese që lidhen me përfshirjen e prindërve. Bëni një listë të sfidave të zakonshme në një letër flip çarti ose tabelë të bardhë.

Shkëmbeni hulumtime ose histori që zhvlerësojnë keqkuptimet e zakonshme rreth përfshirjes së prindërve.

4. Ndërtimi i komunitetit

- Ndani prindërit në grupe të vogla.

- Secili grup diskuton dhe ndan përvojat, idetë dhe shqetësimet e tij për të krijuar një ndjenjë komuniteti midis prindërve.

- Nxitni prindërit të mendojnë për aktivitete që mund t'i bashkojnë ata jashtë seminarit. Prezantoni në një grup të madh.

5. Përcaktimi i qëllimeve

- Kthejini prindërit në grupe të vogla. Shpërndani letra dhe stilolapsa prindërve.

- Kërkojuni atyre të shkruajnë një ose më shumë qëllime specifike në lidhje me pjesëmarrjen e tyre aktive në kujdesin parashkollor. Diskutoni këto synime në grupe të vogla dhe zgjidhni disa për t'i ndarë me të gjithë grupin.
- Nxitni përkushtimin për arritjen e këtyre qëllimeve dhe shkëmbeni informacione kontakti për më tutje.
- Përmbliidhni pikat kryesore të diskutuara në seminar, shkruajini ato në një tabelë.
- Falënderoni prindërit për pjesëmarrjen e tyre dhe theksoni rëndësinë e përfshirjes së tyre aktive në kujdesin parashkollor.
- Ndani informacionet e kontaktit dhe detajet rreth seminarit të ardhshëm ose aktiviteteve vijuese.

4. Kuptimi më i thellë i kompetencave relacionale

Pika bazë teorike e nisjes së projektit në lidhje me bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në punën dhe vendimmarrjen në kopsht është koncepti i kompetencave relacionale, të cilin e përkufizojmë si:

"Gatishmëria dhe aftësia e profesionistit për të "parë" çdo fëmijë si një individ dhe për të përshtatur sjelljen e tij në përputhje me rrethanat pa hequr dorë nga udhëheqja, si dhe aftësia për të qenë autentik në kontaktet e tij me fëmijën dhe si aftësia e profesionistit për të marrë përgjegjësinë e plotë mbi cilësinë e marrëdhënieve." (Jull & Jensen, 2014)^{viii}

Jemi përcaktuar të plotësojmë konceptin teorik me parimet e prindërimit pozitiv që besojmë se plotësojnë dhe ofrojnë një bazë cilësore për të punuar me prindërit. Familja luan një rol kyç në edukimin e fëmijës, kështu që kopshti duhet të mbështesë prindërimin pozitiv duke respektuar dhe promovuar pikat e forta dhe aftësitë që prindërit kanë nevojë për të përmbushur rolin e tyre.

Historia e kompetencave relacionale shkon përtej kornizës teorike dhe ekziston në shkollat dhe kopshtet moderne. Shikoni disa nga projektet e rëndësishme që po zbatohen në shkolla dhe kopshte anembanë Evropës, të cilat bazohen në teorinë e kompetencave relacionale.

Projekti Dorë për Dore – Fuqizimi i mësimdhënësve në të gjithë Evropën për t'u përballur me sfidat e karrierës në lidhje me çështjet sociale, emocionale dhe të diversitetit
<https://handinhand.si/en/home2/>

Projekti 'Empathie macht Schule' – i ndihmon profesionistët të thellojnë aftësitë e tyre të ndërtimit të marrëdhënieve dhe ndjeshmërisë për të krijuar një mjedis mësimor të ndërgjegjshëm dhe zhvillimor për të gjithë.
<https://www.empathie-macht-schule.de/projekt-2/>

"Nga respekti te përgjegjësia" - projekt që zbatohet për të katërtin vit dhe i cili i referohet lidhjes së profesionistëve nga Serbia, Kroacia dhe Sllovenia për zhvillimin e kompetencave relacionale.
<https://familylabassociation.com/projects/>

Komunikimi midis shtëpisë dhe kopshtit duhet të jetë i rregullt, i dyanshëm dhe kuptimplotë. Së këndejmi, udhëzuesi ofron disa nga kushtet për komunikim cilësor.

Eksperti	Praktikuesi
Të tjerët supozojnë se unë kam njohuri dhe duhet ta dëshmoj atë pavarësisht nëse jam i/e sigurt në njohuritë e mia.	Të tjerët supozojnë se kam njohuri, por nuk jam i vetmi në këtë situatë dhe jo vetëm njohuritë e mia janë kritike dhe të rëndësishme. Pasiguria ime do të jetë një nxitje për mua dhe prindin për të mësuar.
Mbani prindërit tuaj larg dhe qëndroni në rolin e ekspertit. Jepini prindërve përshtypjen se jeni ekspert, por edhe i ngrohtë dhe dashamirës "që ju zbut".	Po kërkoj një rrugë drejt mendimeve dhe ndjenjave të prindërve. Lejo që respekti i tij për njohuritë e mia të rritet ndërsa ai zbulon gjithnjë e më shumë.
Kontrolloni respektin dhe statusin tim si ekspert përmes reagimit të klientit.	Kontrolloni ndjenjën e lirisë dhe lidhjen reale me klientin sepse nuk duhet të mbaj më rolin e ekspertit.

4.1. Kompetencat relacionale

Mbani mend: Si dhe pse bëni diçka është shpesh më e rëndësishme se ajo që bëni.

Rekomandohet: Kompetencat relacionale në shkollat publike
<https://www.youtube.com/watch?v=Vg1fKkwKJyo>

Puna me kompetenca relacionale përfshin:

- Njohuri për reagimet emocionale
- Njohuri për aftësinë tonë të trashëguara për t'u socializuar
- Njohuri për zhvillimin socio-emocional

Dihet se të mësuarit është një aktivitet i ngarkuar emocionalisht. Të mësuarit dhe përpunimi konjitiv janë të lidhura thellësisht me përgjigjet emocionale. Kur duam të kuptojmë se si mësohet diçka, gjithmonë duhet t'i kushtojmë vëmendje të singertë situatës konkrete dhe të kuptojmë se mënyrat tona të lidhjes dhe komunikimit ndikojnë te nxënësit.^{ix}

Koncepti i kompetencave relacionale është një koncept që përdoret vetëm në lidhje me profesionistët për shkak të marrëdhënieve asimetrike që profesionistët ndërtojnë me fëmijët dhe prindërit e tyre. Ato janë asimetrike për shkak se profesionisti ka më shumë fuqi si pjesë e një sistemi të vendosur, ashtu edhe për shkak të përvojës dhe njohurive më të mëdha që vijnë nga arsimimi dhe pozita e tij.

Shpeshherë, i shohim fëmijët, ndërsa ndonjëherë dhe prindërit si ata që duhet të fajësojnë kur diçka në marrëdhënie shkon keq. Në vend që të fajësoni njërin nga palët (mund të jetë edhe profesionisti), do të ishte shumë më e dobishme të shihnit profesionistin si përgjegjës për cilësinë e marrëdhënies.

Kur flasim për përfshirjen e prindërve, ne shpesh fokusohemi në aktivitete të lidhura me përmbajtjen që përfshijnë prindërit dhe profesionistët, por ajo që është po aq e rëndësishme është se si ka qenë atmosfera para, gjatë dhe pas aktiviteteve konkrete.

Këtë e quajmë dimensionin e procesit të marrëdhënies – përkatësisht mënyra se si profesionisti krijon mjedisin për përfshirjen e prindërve. Pra, çdo marrëdhënie/situatë ka të paktën dy dimensione, çfarë po bëjmë bashkë dhe si po e bëjmë atë? Dhe çfarë është më e rëndësishme kur u mësojmë profesionistëve për kompetencat relacionale.

Profesionistët mbi të gjitha kanë përgjegjësi procedurale, pra përgjegjësi për tonin, atmosferën dhe disponimin në punë. Profesionistët nuk janë të vetmit përgjegjës për rezultatin e bashkëpunimit! Nuk duhet harruar dhe rolin e prindërve!

Por, duke marrë përgjegjësinë për procesin, profesionistët krijojnë një atmosferë në të cilën prindërit janë më të hapur për bashkëpunim dhe kështu krijohen rezultate.

Ndonjëherë, rrethanat mund të jenë shumë sfiduese dhe mund të jetë shumë e vështirë për profesionistin të shohë këtë përgjegjësi. Shpeshherë, profesionistët kanë përvojë personale se e gjithë "fuqia" është në duart e prindërve. Nga ana tjetër, prindërit shpeshherë ndihen të pambrojtur dhe të ekspozuar ndaj fuqisë së institucionit dhe gjykimit profesional, veçanërisht kur vijnë nga familje të rrezikuara. Nëse profesionisti njuh ndikimin dhe përgjegjësinë e tij, kjo i jep atij fuqinë për të bërë diçka për të ndryshuar atë që ai mendon se duhet ndryshuar.

Si mundet profesionisti të krijojë një mjedis të mirë për përfshirjen e prindërve? Kjo është e mundur nëse profesionisti e di se si ta krijojë këtë mjedis dhe është i gatshëm të marrë përgjegjësinë e plotë për ta bërë këtë.

Do të shpjegojmë disa nga parimet bazë të kësaj qasjeje që mund të kontribuojnë në një kuptim më të mirë të dinamikës së familjes dhe sjelljes së prindërve dhe profesionistëve.

4.2. Integriteti dhe bashkëpunimi

Integriteti është tërësia e ndjenjave, vlerave, mendimeve të një individi si mendërisht ashtu edhe fizikisht. Fëmija vjen në botë me integritetin e tij, i cili në kuptimin më të gjerë përfshin nevojat dhe kufizimet e tij. Përderisa rriten, integriteti i tyre bëhet më kompleks në ndërveprim me të tjerët. Kujdesi për integritetin personal dhe zhvillimin njerëzor të fëmijës është pjesë e përgjegjësisë së prindërve, por edhe e praktikës profesionale.

Fëmija zbulon identitetin e tij dhe marrëdhënien e tij me veten përmes reagimeve nga prindërit dhe më vonë nga edukatorët. Për shembull, nëse një foshnjë refuzon ushqimin e ofruar nga nëna e tij dhe nëna përgjigjet me: "Je ngopur, nuk dëshiron më", fëmija mëson të njohë ngopjen e tij. Nga ana tjetër, nëse nëna këmbëngul, duke thënë: "Nuk ke ngrënë asgjë, merr dhe një kafshatë tjetër ose do të jem e trishtuar", fëmija mund të fillojë t'i japë përparësi gjykimeve të njerëzve të tjerë mbi ndjenjat e veta të urisë ose të ngopjes.

Që në ditën e parë të jetës, fëmijët mund të shprehin kufijtë dhe nevojat e tyre, por nuk mund t'i mbrojnë ato. Ata mbështeten shumë në ndjeshmërinë e të rriturve për të njohur dhe për t'iu përgjigjur këtyre nevojave. Prindërit luajnë një rol jetik për të kuptuar se kush është në të vërtetë fëmija i tyre, duke i dalluar ata jo vetëm nga fëmija mesatar, por edhe nga dëshirat, shpresat dhe pritshmëritë e tyre.

Tradicionalisht, fokusi ka qenë kryesisht në mësimin e fëmijëve për vlerat, normat dhe rregullat sociale, duke i udhëhequr në thelb se si të bëhen pjesë e një familjeje, grupi apo shoqërie. Megjithatë, është po aq e rëndësishme që të nxiten individë të fortë që kuptojnë nevojat, dëshirat dhe emocionet e tyre. Nuk bëhet fjalë për egoizëm, por për komunikim të qartë dhe ndërtim marrëdhëniesh të bazuara në respekt dhe dinjitet të barabartë.

Bashkëpunimi shihet shpesh sikur dikush kur e gjen vendin e vet në një grup. Por, në çdo marrëdhënie ndërpersonale, lindin konflikte midis dëshirës për të bashkëpunuar dhe nevojës për të ruajtur integritetin. Ky konflikt zakonisht zhvillohet tek secili individ.

Për shembull, edukatorët synojnë të krijojnë bashkëpunim me prindërit për të mbështetur fëmijën në një mjedis grupor. Prindërit mund të tregojnë agresion verbal, mosinteresim ose mosbashkëpunim, ndërsa edukatorët kanë nevojë për bashkëpunim dhe komunikim të respektueshëm. Kjo ilustron ekuilibrin delikat midis këtyre dy nevojave.




Figura 1: Raporti i konfliktit ndërmjet integritetit dhe bashkëpunimit

Mendoni për reagimet tuaja tipike në situata të tilla. Si i trajtoni konfliktet e brendshme? Ndoshta mund të mendoni për raste kur i keni dhënë përparësi bashkëpunimit mbi nevojat tuaja dhe për raste kur keni zgjedhur vetë-ruajtjen, edhe nëse kjo ka çuar në konflikt. Është e nevojshme të mendoni për prirjet tuaja dhe si i zgjidhni konfliktet e brendshme.

Ekzistojnë dy kritere për të gjykuar se si i zgjidhni konfliktet e brendshme: nëse i jepni përparësi bashkëpunimit apo integritetit, dhe nëse e bëni këtë me zgjedhje apo nevojë. Çelësi është të zgjidhni me vetëdije veprimet tuaja, edhe kur përballeni me konflikt.

Nëse lëvizni shumë drejt bashkëpunimit ose integritetit dhe nuk i lejoni vetes lirinë për të zgjedhur, atëherë mund të bëheni shumë të bindur ose rezistent. Gjetja e këtij ekuilibri është kritike për parrandalimin e djegies psikologjike.

Zgjidhja e konflikteve të brendshme nëpërmjet lirisë së zgjedhjes nuk i eliminon konfliktet ndërpersonale, por krijon mundësi që këto konflikte të jashtme të zgjidhen me respekt dhe vlerë reciproke. Arti i kultivimit të marrëdhënieve të shëndetshme përfshin bashkëpunimin pa cenuar integritetin e askujt, tuajin apo të dikujt tjetër.

Pyetje për të menduar:

- Në marrëdhëniet tuaja profesionale, a bashkëpunoni më shpesh apo i jepni përparësi integritetit?
- A mund të mendoni për tre raste në përvojën tuaj profesionale kur ju është dashur të vendosni një ekuilibër midis bashkëpunimit dhe integritetit?
- Si ndiheni kur jeni në situata ku duhet të bashkëpunoni ose të ruani integritetin? Po sikur të keni një zgjedhje?
- Mendoni për ndërveprimin tuaj me prindërit tuaj. A priren ata të bashkëpunojnë apo të kenë prioritet integritetin në marrëdhënien tuaj me ta dhe si e shpjegoni këtë?
- A mund të mendoni për një shembull të punës me prindërit kur ata kanë zgjedhur të bashkëpunojnë me kërkesat institucionale në dëm të integritetit të tyre?

4.3. Përgjegjësia

Sa për fillim, është e rëndësishme të përkufizohet termi përgjegjësi. Përgjegjës është ai që ka aftësi në personale për t'u përgjigjur, për të hedhur një hap. Ai që sillet në përputhje me veten dhe mjedisin e tij është përgjegjës; është përgjegjës kur ndërmerret një procedurë (përgjegjësi) në lidhje me nevojat, dëshirat dhe interesat e tij personale si dhe nevojat dhe mundësitë e mjedisit në të cilin ndodhet.⁷

Ekzistojnë dy lloje të përgjegjësisë:

1. Përgjegjësi personale

Përgjegjësia ekzistenciale që kanë të gjithë njerëzit që nga dita e parë e jetës e cila ka të bëjë me integritetin e tyre – mendimet, emocionet, sjelljet, trupin, idetë, dëshirat, besimet, ëndrrat, etj.

2. Përgjegjësi shoqërore

Përgjegjësia për familjen, grupin e kopshtit, për rregullat shoqërore, respektimin e ligjit, etj.

Dallimi midis këtyre dy përgjegjësisë është se përgjegjësia shoqërore mund t'i transferohet një personi tjetër. Për shembull, nëse sëmurem, një koleg mund të marrë përsipër punën time. Askush përveç nesh nuk mund të marrë përgjegjësi personale (edhe pse jo të gjithë e marrin përsipër të tyren).

Marrja përsipër e përgjegjësisë personale është një tregues i shëndetit mendor duke ushtruar në mënyrë aktive përgjegjësinë për atë që themi, atë që pimë, atë që hamë, për kufijtë që vendosim me njerëzit e tjerë, nëse mund të themi jo - ose nëse kujdesemi për kufijtë tanë, mënyra se si e trajtojmë trupin tonë, mendimet tona, nëse i kalojmë kufijtë tanë, etj.

